

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE

Fakulteti Juridik

STUDIME POSTDIPLOMIKE-MASTER

DREJTIMI SIGURI



Reformat në Ministrinë e Punëve të Brendshme në Maqedoni nga viti 2012

PUNIM MASTERI

Mentori:

prof. Besa Arifi

Kandidati:

Iilir Seadini

Tetovë, 2019

PËRMBAJTJA:

ABSTRAKT	5
LISTA E SHKURTESAVE	6
HYRJE	7

Kapitulli i parë:.....10

1. Ministria e Punëve të Brendshme	10
2. Ministri	11
3. Sekretari shtetëror	11
4. Byroja për siguri publike	12
4.1. Qendra e shërbimit policor	13
4.2. Departamenti i teknikës kriminalistike	13
5. Drejtoria për siguri dhe kundërzbulim	14
6. Marrëdhëniet me publikun	14
7. Kontrolli i brendshëm	16
8. Bashkëpunimi ndërkombëtar	16
8.1. Europol	18
8.2. Interpol	19
8.3. Selek	20
9. Qendra për trajnim.....	20
10. Oficeri për mbrojtjen e të dhënave personale	22

Kapitulli i dytë:.....23

1. Reforma Ligjore	23
2. Procedura e hartimit të ligjeve.....	24
2.1. Ligjete propozuara për policinë	24
3. Ligji për polici dhe aktet nënligjore	24
4. Hetime.....	26
5. Ligji për ndryshimin e Ligjit për Punë të Brendshme.....	26
5.1. Ligji për përcjelljen e komunikimeve	28
5.2. Ligji për kontroll ndërkuftar dhe aktet nënligjore.....	28

Kapitulli i tretë:30

1. Përgjegjësia dhe marrja e këshillave	30
2. Promovimi i vlerave Evropiane	30
3. Përafrimi i legjislacionit	30
4. Maqedonia dhe Evropa	31
4.1. Si duhet të zhvillohet Maqedonia	31
5. Siguria dhe komuniteti	31
6. Marrëveshja për stabilizim asocim	32
7. Qendra kombëtare koordinuese.....	33
8. Operacionet politike për parandalimin e krimit	34
9. Mbështetja e Bashkimit Evropian	35
9.1. NATO	37
9.2. Unioni Evropian	37

Kapitulli i katërt:	38
1. Sistemi i sigurisë në Maqedoni	38
1.1. Raportimi i krimit në Maqedoni	39
1.2. Roli i policisë dhe aparatit të sigurisë	41
1.3. Zbatimi i ligjit, deklaratat e Brukselit	43
2. Përmirësimi i kushteve të punës	45
3. Korrupsioni dhe afera e përgjimeve	45
4. DSK në Agjencinë për Siguri Kombëtare	47
5. Formimi i Agjencisë Tekniko- Operative	48
6. Byrja për Siguri Publike	50
7. Kontrolli i Brendshëm	51
8. Mbikëqyrja e punës së MPB-ës	51
9. Vettingu në Polici	54
Shtojca	56
Përfundime dhe Rekomandime	58
Bibliografia	60

Abstrakt

Siguria e vendit është një parakusht për zhvillimin e një shteti.

Sistemi i sigurisë i Republikës së Maqedonisë Veriut duhet të synojë zbulimin, parandalimin dhe eliminimin e kërcënimeve dhe rreziqeve për sigurinë e vendit.

Sistemi i sigurisë është një grup kompleks i masave aktive, planeve dhe programeve, si dhe institucioneve përkatëse në të gjithë vendin, për përmirësimin e sigurisë.

Interesi shtetëror është ruajtja e pavarësisë, sovranitetit shtetëror, integriteti rajonal dhe karakteri unitar si një kuadër thelbësor për ruajtjen dhe promovimin e identitetit kombëtar, shprehjes së lirë dhe identitetit kulturor, etnik për të gjithë qytetarët.

Sistemi i sigurisë duhet të drejtohet, mbi të gjitha në mbrojtjen e interesave vitale dhe jetike të vendit sipas Konceptit të Sigurisë Kombëtare dhe Mbrojtjes.

Mbrojtja dhe promovimi i paqes dhe sigurisë, jetës, shëndetit dhe pasurisë së qytetarëve të Republikës Maqedonisë.

Zhvillimi i një shoqërie multietnike të bazuar në besimin reciprok, përpjekjet e përbashkëta dhe përpjekjet e të gjitha bashkësive etnike për stabilitetin dhe përparimin e gjithanshëm të shtetit.

Mbrojtjen dhe promovimin e themeleve demokratike, juridike, demokracisë parlamentare, ndarja e pushteteve në mënyrë të drejt, sundimi i ligjit, respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut si dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme dhe përmirësimi i sigurisë së brendshme të shoqërisë dhe shtetit.

Në mënyrë që të ruhet siguria e vendit, është e nevojshme që shteti të ndërmerr dhe duhet vazhdimisht të promovojë masa dhe aktivitete për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e efikasitetit dhe objektivitetit të mjeteve, metodave për mbledhjen e të dhënave dhe informacionit të rëndësishëm për sigurinë, në mënyrë që të parandaloj rreziqet.

Ruajtjen dhe përmirësimin e kapaciteteve të sigurisë, aftësitë për të parandaluar, minimizuar, eliminuar rreziqet e sigurisë dhe kërcënimet, si dhe zgjidhjen e konflikteve në situata krize.

Me reforma synohet të sigurohet efikasiteti, përgjegjësia dhe transparenca e pushtetit policor në zbatimin dhe funksionimin e shtetit të së drejtës, përmirësimin e shërbimeve policore, dhe respektimi i detyrës.

Lista e shkurtesave

RMV – Republika e Maqedonisë së Veriut

MPB – Ministria e Punëve të Brendshme

DSK – Drejtoria për Siguri dhe Kundërzbulim

BSP – Byroja për Siguri Publike

ATO – Agjencia Teknike Operative

BE – Bashkimi Evropian

UE – Unioni Evropian

SPB – Sektori për Punë të Brendshme

OKB – Organizata e Kombeve të Bashkuara

INTERPOL – Organizata Ndërkombëtare e Policisë

OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

EUROPOL – Agjencia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunimin e Zbatimit të Ligjit

EAR - Agjencia Evropiane për Rindërtim

RSFJ – Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë

UDBA – (Управа државне безбедности) Drejtoria e Sigurisë Shtetërore

AP –Administrata Publike

MSA - Marrëveshja e Stabilizim Asocimit

Hyrje

Duke folur për Reformat e Sektorit të Sigurisë, nënkuptojmë reformat që duhet të zbatohen në institucionet shtetërore përgjegjëse për sigurinë e shtetit me qëllimin për të garantuar një shtet të sigurt dhe një qeveri legjitime. Ky proces duhet të marrë orientim drejt aftësisë të sistemit administrativ për tu ballafaquar me kërkesat e qytetarëve dhe nevojat e shoqërisë bashkëkohore. Në këtë drejtim, është e nevojshme të përcaktohet të ndryshojë qëndrimet për reformimin e sektorit të sigurisë.

Kështu, Konventa e OKB-së për Krimin e Organizuar Transnacional përcaktohet në rezolutën 55/25, aneksi I i Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, e cila është definuar si një grup i organizuar dhe i strukturuar me qëllim luftimin e kryerësve të veprave penale.

Me reforma synohet të sigurohet efikasitet dhe përgjegjësi e pushtetit ekzekutiv në zbatimin e së drejtës, përmirësimin e shërbimeve publike për qytetarët, kontrollin e harxhimit të mjeteve nga buxheti, thjeshtësimin e procedurave administrative në ushtrimin e veprimtarive të ndryshme. Sistemi i sigurisë i Republikës së Maqedonisë mund të përkufizohet si një sistem i cili lufton kundër kërcënimeve dhe rreziqeve ndaj pavarësisë dhe integritetit territorial të vendit, të drejtave dhe lirive të qytetarëve, parandalimin e minimumit të institucioneve demokratike dhe nxitjen e intolerancës kombëtare dhe fetare në vend, luftën kundër krimit të organizuar, spiunazhit, terrorizmit, pastrimit e parave, kontrabandës me mallra ilegale tregtare kundër interesave ekonomike dhe politike të vendit.

Sistemi i sigurisë kombëtare është kërkesa për të ruajtur stabilitetin e shtetit përmes përdorimit të ekonomisë, diplomacisë, projektimit e pushtetit dhe fuqisë politike.

Ndërtimi i një administrate publike e cila do të jetë e aftë ta integrojë vendin në Nato dhe Bashkimin Evropian, t'i realizojë detyrimet e dhëna, që paraqesin prioritet kryes në këtë drejtim. Procesi i integruar kërkon reforma të administratës publike edhe në drejtim të ngritjes së institucioneve të qëndrueshme, koordinimit të ngushtë të aktiviteteve dhe bashkëpunimit midis strukturave administrative të cilat do të jenë kompetente për realizimin e reformave.

Kërcënimet e sigurisë i përfshijnë jo vetëm armiqtë konvencional si shtetet e tjera nacionale, por edhe aktorët jo shtetërorë, si grupet e dhunshme, kartelet narkotike, korporatat shumëkombëshe dhe organizatat joqeveritare.

Marrëveshja për Stabilizim dhe Asocim me Bashkimin Evropian (paragrafi 4 i preambulës) i

përcakton reformat në administratën publike si një nga objektivat e saj, ndërsa neni 74 parasheh detyrim për Republikën e Maqedonisë që t'i kushtojë kujdes të veçantë përforsimit të institucioneve në të gjitha nivelet e administratës dhe zbatimin e së drejtës.

Qëllimi kryesor i hulumtimit është të shihet shkalla e lidhjes së faktorëve të caktuar që lidhen me qytetarët, punën e komunitetit dhe policisë me komunitetin, përsigurinë e vendit.

Objektivat specifike të hulumtimit, duke përfshirë informacionin, analizën shkencore e çdo lloj ngjarje që ka cenuar të drejtat dhe të mirat juridike të qytetarëve.

Në Maqedoni ndër vite janë krijuar rrethana të ndryshme, ekonomike, politike, juridike, sociale dhe sidomos viteve të fundit ku vendi jonë ka kaluar disa faza dhe reforma të mëdha në të gjitha sferat, konkretisht në fushën e sigurisë, gjyqësisë, prokurorisë etj.

Çdo lloj aktiviteti kriminal është i dëmshëm për shtetin dhe shoqërinë në përgjithësi.

Duke marr parasysh se Ministria e Punëve të Brendshme si një ndër sektorët më të ndjeshëm dhe më të mbyllur të shtetit, dhe duke parë mungesën e studimit të reformave të cilat u bënë të domosdoshme, vendosa të përcaktohem për këtë temë.

Arsyeja e hulumtimit të reformave në MPB, është kapja e organit nga pushteti, politika, abuzimi me pushtetin, diskriminimi, viktimizimi nga policia, korrupsioni, mosbesimi i qytetarëve ndaj MPB, përgjimi ilegal dhe krejt në fund procesi i reformave, reformat e bëra deri në fund, ndryshim ligjet, propozim ligjet, reformat e propozuara, planet strategjike etj.

Duke studiuar dhe krahasuar punën dhe ligjet e policisë nga viti 2012, mund të shohim fajësinë e punonjësve, shtypjen, ndikimin politik, aftësitë profesionale të punonjësve, shkarkimet dhe emërimet partiake.

Hipoteza e veçantë, Ndjenja e frikës dhe ankthit në mesin e qytetarëve zvogëlon numrin e tyre vullnetin për të marr pjesë në aktivitetet parandaluese të krimit.

Metodologjia e punës, ky punim ka qenë i domosdoshëm. Informacionet e shfrytëzuara janë marr nga punime të fakulteteve të sigurisë, drejtësisë, nga MPB dhe policia, ekspert të sigurisë, profesor universitar, ligjet e mëparshme, ligje në fuqi, plane strategjike si ai 3-6-9, deklaratat e Brukselit, 2015, 2017etj.

Struktura e planit, ky punim shkencor përmban, abstrakt, pjesën hyrëse, katër kapituj, plane strategjike të MPB, përfundim dhe literaturën.

Në kapitullin e parë, flitet kryesisht për strukturën e MPB, rolin dhe kompetencat e drejtorive.

Kapitulli i dytë, flitet për krahasim ligjesh, ligjet e reformuara dhe miratuara, propozim ligjet dhe

propozim ligjet nga Bashkimi Evropian.

Kapitulli i tretë, flet për rolin dhe ndikimin e institucioneve Evropiane dhe Bashkimit Evropian në reformat në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Kapitulli katër, fokusohet në reformat e bëra në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndarja, funksionimi, menaxhimi i drejtorive, mekanizmat për mbikëqyrjen e punës së MPB.

Përfundim i këtij punimi, janë konstatimet kryesore mbi reformat, dhe një vështrim i posaçëm mbi ndarjen e drejtorive nga MPB.

Në fund të punimit është dhënë regjistri i literaturës së përdorur për këtë punim masteri.

Reformat e Administratës publike në kontekst të EU-integrimeve

Nevojat për reforma në administratën publike nuk duhet të imponohen vetëm si kushte të progresit drejt integritimit të vendit në UE, sepse reformat nuk janë qëllim për vete, por ato janë nevojë për ngritjen dhe ndërtimin e një administrate efikase, të dobishme, profesionale, kompetente, transparente, llogaridhënëse e të përgjegjshme në funksion të shërbimit të qytetarëve, biznesit dhe Evropës, por para së gjithash ato u nevojiten qytetarëve dhe shtetasve në funksion të përmbushjes së nevojave të tyre, për çka ata edhe paguajnë përmes sistemit të taksave.¹

¹ A.Bexheti, Disertacion i doktoratës “Shpenzimet publike në shtetet bashkëkohore dhe në RM - aspektet e racionalizimit dhe optimizimit, fq. 126, qershor 2002, Shkup

Kapitulli I

1. Ministria e Punëve të Brendshme

Njëri ndër resorët më të rëndësishëm të shtetit është Ministri e Punëve të Brendshme, ku angazhimin më të madh e ka në realizimin e sistemit të sigurisë shtetërore dhe publike.

Politika realizuese e Ministrisë së Punëve të Brendshme, është kryekëput e lidhur me vetë të drejtat themelore dhe lirive të njeriut.

Të gjitha aksidentet që ndodhin brenda territorit të republikës, dhe shkeljet e ndryshme ligjore janë nën kompetencën e Ministrisë së Brendshme për zgjidhjen e tyre, duke përfshirë këtu edhe shkeljet e rregullave kufitare dhe kalimet ilegale nëpër kufijtë shtetëror.

Kjo ministri ka përgjegjësi para Qeverisë dhe Parlamentit nga të cilat edhe mund të ushtrohet mocion votëbesimi.

Qëllimi parësor i kësaj Ministrie është luftimi i dukurive devijante që e rrezikojnë shoqërinë, goftë luftimin e kriminalitetit, terrorizmit, korrupsionit dhe nepotizmit nëpër organet e administratës shtetërore në përgjithësi duke pasur për synim ruajtjen e rendit publik dhe ruajtjen e qytetarëve nga rreziqet e këtilla.²

Në kuadër të MPB-ës, janë të krijuar nënorganet më të ulëta me qëllim të ndarjes së punëve gjatë realizimit të tyre, siç është:

Drejtoria për Siguri dhe Kundërzbulim dhe Byroja për Sigurim Publik.

² Ligji mbi organizimin dhe punën e Organeve të Administratës Shtetërore. Gazeta Zyrtare nr. 58, Ligji mbi organizimin dhe punën e Organeve të Administratës Shtetërore. Gazeta Zyrtare nr. 58 viti 2000. Ibrahim Ceka, Qasja mbi parimet e Administratës Publike, fq. 171

2. Ministri

Etimologjia e fjalës ministër vjen prej latinishtes minister, që do të thotë ai që shërben, që ndihmon, që ekzekuton.

Ministri është një anëtar i qeverisë i ngarkuar me një fushë kompetencash (një portofol), që zakonisht përcaktohen me dekret të kryeministrit, që drejton një ministri ose një departament ministrie, të përbërë nga administrata dhe shërbimet publike.

Ai përfaqëson ministrinë e tij në gjirin e qeverisë dhe drejton politikën e vendosur për fushën e tij. Ministri është person juridik, publik, që përfaqëson dhe drejton ministrinë.

Një ministër i deleguar vendoset drejtpërsëdrejti nën autoritetin e Kryeministrit për të kryer një mision të veçantë.

Një ministër Shteti është një ministër që i atribuohet një titull honorifik, që mban parasysht personalitetin e tij ose vlerat e tij përfaqësuese.

Ai gjithashtu vendos për të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e nëpunësve shtetërorë dhe të punësuarve tjerë në ministri pa statusin e nëpunësve shtetërorë, nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

3. Sekretari Shtetëror

Sekretari Shtetëror i Ministrisë së Brendshme emërohet dhe shkarkohet nga Qeveria me propozimin e Ministrit për një periudhë prej katër vitesh.

Sekretar Shtetit mund të emërohet një person që i plotëson kushtet, duke qenë shtetas i Maqedonisë së Veriut, të mos ketë të shqyptuar dënim me burgim ose kundërvajtje për shtrimin e profesionit, të jetë i arsimuar me së paku 240kredi, të ketë përvoj pune pesë vite, të njohë gjuhë të huaja, dhe të ketë kaluar testet psikologjike.

Sekretari Shtetëror mund të shkarkohet me kërkesë të tij, kur dënohet për një vepër të dënueshme me burgim prej së paku gjashtë muaj ose për shkak të kryerjes jo etike dhe joprofessionale të punës.³

³ <https://mvr.gov.mk/page/ministerstvo>
http://www.eurm.edu.mk/publikacii/Zborik_Bezbednost_2012_1.pdf
<https://mvr.gov.mk/page/biro-za-javna-bezbednost>

4. Byroja për Siguri Publike

Byroja për Siguri Publik është organ në kuadër të Ministrisë së Brendshme, nga ku organizohet kryerja e punëve policore.

Puna e Byrosë rregullohet me Ligjin mbi Policinë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë "Nr.114 / 06, 09/06 , 145/12 dhe 41/14).

Struktura e brendshme organizative e Byrosë së Sigurisë Publike bazohet në një parim linjash dhe territorial dhe rregullohet me Ligjin për Policinë. Mund të krijohen njësi të veçanta organizative në Byronë Publike për kryerjen e detyrave brenda kompetencave të saj, si dhe njësi organizative për kryerjen e punës së ekspertëve për nevojat e Byrosë.

Byroja udhëhiqet nga një Drejtor i propozuar nga Ministri, emërohet dhe shkarkohet nga Qeveria për katër vite.

Njësitë organizative për kryerjen e punëve policore që janë nën kompetencë të Byrosë Publike:

- a. Departamenti për Çështje Policore është përgjegjës për çdo ditë pune të policisë në fushën e rendit publik dhe aktivitetet e zbatimit në lidhje me situatën komplekse të sigurisë.
- b. Departamenti për operacione të trafikut është përgjegjës në fushën e trafikut dhe parandalimit të aksidenteve në trafik, kontrollin e vozitësve, dhe veprime të tjera në fushën e trafikut.
- c. Departamenti i Policisë Kriminale koordinon masat dhe aktivitetet me njësitë organizative përgjegjëse për krimin dhe Qendrat Rajonale për Çështjet e Kufirit.
- d. Departamenti i Inteligjencës bën përpunimin dhe analizën e të dhënave dhe informacionit mbi metodologjitë e përcaktuara, përgatit raporte analitike dhe bën shpërndarjen e tyre në njësitë organizative.
- e. Sektori për Çështjet e Kufirit dhe Migracionit është përgjegjës për policinë e çështjeve kufitare, aktivitetet e policisë në lidhje me krimin ndërkufitar dhe migrimit, si dhe çështjet që kanë të bëjnë me shtetas të huaj.
- f. Sektori për punë të përbashkëta dhe burime njerëzore në kuadër të Byrosë Publike është përgjegjës për kryerjen e detyrave të caktuara në fushën e burimeve njerëzore, çështjet ligjore dhe financiare, si dhe mbrojtjen e të dhënave.⁴


⁴ <https://mvr.gov.mk/page/ministerstvo>
http://www.eurm.edu.mk/publikacii/Zborik_Bezbednost_2012_1.pdf
<https://mvr.gov.mk/page/biro-za-javna-bezbednost>

4.1. Qendra e shërbimit Policor

Për performancën efektive dhe efikase të detyrave specifike dhe komplekse të policisë që kërkojnë një shkallë të lartë të specializimit brenda Byrosë Publike janë themeluar shërbimet policore qendrore.

Shërbimet policore qendrore kryejnë aktivitetet rreth krimit të organizuar, punën e mjekësisë ligjore dhe të ekspertizës.⁵

4.2. Në kuadër të Byrosë Publike funksionon edhe Departamenti i Teknikës Kriminalistike.



⁵ ibid

5. Drejtori për Siguri dhe Kundërzbulim

Drejtoria e Sigurisë dhe Kundërzbulimit, është organ brenda Ministrisë që kryen punët e brendshme në lidhje me sigurinë dhe kundërzbulimin.

Njëjtë edhe Drejtoria për Kundërzbulim bazohet në një parim linjash dhe territorial, poashtu mund të themelohen njësi organizative brenda kësaj Drejtorie për kryerjen e detyrave brenda kompetencave të saj dhe njësi organizative për kryerjen e detyrave të ekspertëve për nevojat e Drejtorisë.

Drejtoria mund të mbledh të dhëna duke përdorur agjent sekret. Bashkëpunimi me qytetarët e vendit dhe me të huajt, ku bashkëpunimi themelohet në baza vullnetare dhe askush nuk detyrohet të jetë bashkëpunëtor i fshehtë.

Drejtoria mund të mbledhë të dhëna duke përdorur masa dhe procedura të posaçme për mbledhjen e të dhënave në mënyrë të fshehtë nën kushtet e përcaktuara me ligj.

Pas pavarësisë së Maqedonisë, në kuadër të Ministrisë së Brendshme, Shërbimi i Sigurimit të Shtetit vazhdon të ushtrojë detyrat e përcaktuara me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Maqedonisë.

Në vitin 1995 u bë riorganizimi i organeve administrative ku, Shërbimi i Sigurimit të Shtetit është riemëruar si Drejtoria për Siguri dhe Kundërzbulim, dhe ndryshimet në Ligjin për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore.⁶

6. Marrëdhëniet me publikun

Fillimet e Departamentit për Marrëdhënie me Publikun dhe Çështjet Strategjike datojnë që nga viti 2003.

Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun drejtohet nga një ndihmës i ministrit.

Spektori për Marrëdhënie me Publikun dhe Protokollu udhëhiqet nga Shefi i Spektorit.

Departamenti përbëhet nga tre nën departamente kryesore.

6

<http://www.mvr.gov.mk/Upload/Documents/Zakon%20za%20policija,%20precisten%20tekst%2015.04.2015%20.pdf>

a. Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun

Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun përkundër komunikimit të vazhdueshëm me mediat (vendase dhe të huaja) në kuadër të detyrave të saj përmes faqes zyrtare të internetit të Ministrisë së Brendshme, ka komunikim të rregullt me qytetarët në lidhje me çështje të ndryshme të interesit të tyre.

Përveç shpërndarjes së rregullt të llojeve të ndryshme të informacionit mbi veprimet e Ministrisë, është pjesëmarrës pothuajse konstant në projekte të ndryshme, fushata dhe aktivitete të tjera me interes publik të cilat janë në fushëveprimin e punës së Ministrisë së Brendshme.

b. Departamenti për informim të karakterit publik

Departamenti i Informimit Publik, në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit për qasje të lirë në informacione me karakter publik, është në komunikim të vazhdueshëm dhe të rregullt me të gjitha njësitë organizative brenda ministrisë për t'iu përgjigjur me kohë kërkesave të të gjithë kërkuësve të informacionit.

c. Njësia për ngjarjet dhe aktivitetet protokollare.

Ky departament është përgjegjëse për sigurimin e mbështetjes së plotë për aktivitetet e Ministrit, Zëvendës Ministri, Sekretarit dhe Drejtorët e Byrosë për Siguri dhe Kundërzbulim dhe shoqërimin e Ministrit gjatë takimeve protokollare, takime pune dhe zyrtare, takimet me institucionet ndërkombëtare dhe vendore, organizimin e ngjarjeve të ndryshme, forume, konferenca dhe ngjarje në fushën e marrëdhënieve me publikun, të përditësime, të shkurtra dhe informacione me personat apo institucionet që duhet të plotësohen, agjenda e punës, përgatitjen e fjalimeve, organizimin e udhëtimeve të punës në ministri, jashtë ambienteve të ministrisë, si dhe sigurimin e pritjes së zyrtarëve të lartë dhe zyrtarëve nga jashtë, strehimin e tyre dhe organizimin e udhëtimit dhe shëtitjen e tyre.⁷

⁷ <https://mvr.gov.mk/profilepage/sektor-za-odnosi-so-javnosta>

7. Kontrolli i brendshëm

Sipas Ligjit për Punë të Brendshme, Kontrolli i Brendshëm është një njësi organizative e pavarur e Ministrisë së Punëve të Brendshme që ushtron kontroll të brendshëm për nevojat e Ministrisë dhe zhvillon procedura për vlerësimin e ligjshmërisë së sjelljes së të punësuarve në Ministrinë e Brendshme.

Qytetarët kanë të drejtë të parashtrijnë ankesë tek Ministria ose Departamenti për mbrojtjen dhe ushtrimin e të drejtave të tyre, kur konsiderojnë se veprimet e punonjësit në Ministri shkelin liritë dhe të drejtat e tyre. Për shqyrtimin e kryer të pretendimeve në ankesë, Departamenti duhet të njoftojë aplikuesin në afat jo më të gjatë se 30 ditë nga marrja e ankesës në kushtet e përcaktuara dhe masat e ndërmarra.⁸

Kontrolli i Brendshëm, me luftën kundër korrupsionit brenda policisë duhet të ndërmer masa dhe veprime për të ngushtuar hapësirën e sjelljes korruptive të punonjësve të Ministrisë dhe policisë, dhe sanksionim të duhur për çdo rast të paligjshëm dhe sjellje joprofesionale nga të punësuarit në Ministri. Duke marr parasysh angazhimin për zbatimin e plotë të funksionit parandalues, Departamentit për Kontroll të Brendshëm, duhet të kryej kontrole të vazhdueshme në njësitë organizative të Ministrisë për zbatimin konsekuent të rregullave, duke vepruar në pajtim me rregullat dhe marrëdhëniet me qytetarët, si dhe respektimin e plotë të lirive dhe të drejtave të njeriut, me qëllim të realizimit të funksionit të policisë si shërbim për qytetarët.⁹

⁸ Mojanoski, C. (2010). Puna e policisë përmes prizmit të qytetarëve, vjetore në Fakultetin e Sigurisë, Shkup, 2010, f. 297-310, f. 308

Mostra mbulonte pothuajse të gjitha komunat në Republikën e Maqedonisë me mbi 20,000 banorë.18 Brenda fushës së parandalimit të krimit, pjesë e aktiviteteve të studentëve, nën drejtimin e mësuesit të lëndës Assoc. Dr. Vesna Stefanovska, do të kryejnë anketime me qytetarë në shumë komuna.

Kusow, M. Abdi, Wilson, C. Leon, Martin, E. David (1997). Determinants of citizen satisfaction with the police, the effects of residential location, Policing: An International Journal of Police strategies and management, American Journal of Police, Vol.20, Issue 4.

Yuksel, Y.& Tepe, F. (2013). Citizen satisfaction with police and community policing, European Scientific Journal, Vol.9, No14.

⁹ <https://mvr.gov.mk/page/sektor-za-vnatreshna-kontrola>

(Dispensë) E drejta policore (për përdorim intern) Jeton Shasivari, Shkurt 2016, Tetovë, faqe 64

8. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Departamenti për Bashkimin Evropian është njësi organizative në kuadër të Ministrisë së Brendshme e cila i koordinon aktivitetet e Ministrisë në lidhje me çështjet e Bashkimit Evropian, IPA fondet dhe ndihma të tjera nga jashtë shteti, çështjet e bashkëpunimit dypalësh dhe shumëpalësh të Ministrisë.

a. Departamenti për Bashkëpunim Ndërkombëtar

Departamenti për Bashkëpunim Ndërkombëtar është njësi e veçantë organizative brenda Sektorit për Bashkimin Evropian dhe Bashkëpunimin Ndërkombëtar. Ky departament është përgjegjës për koordinimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në Ministrinë, dhe puna e kryer ka për qëllim krijimin e një marrëdhënie të bashkëpunimit dhe komunikimit me përfaqësues diplomatikë dhe konsullorë në vend, organizatat e huaja, të misioneve dhe institucioneve të OKB-së, BE-së, OSBE-së, Nato dhe të tjera, hartimin dhe zbatimin e dokumenteve ndërkombëtare dhe komunikimin në nivel ndërkombëtar.¹⁰

Objektivi kryesor i këtij departamenti është që të bashkëpunojë me organizatat rajonale dhe ndërkombëtare, brenda dhe jashtë Republikës së Maqedonisë, duke lejuar përfaqësuesit e Ministrisë së Brendshme për të marrë pjesë në konferenca të ndryshme ndërkombëtare dhe seminare, duke fituar përvojë ku pastaj t'i praktikojnë në punën e tyre të përditshme.

Përgjegjësi e departamentit është edhe përkthimin i shkruar i dokumenteve, kryesisht për Kabinetin e Ministrit, por edhe për njësitë e tjera në kuadër të Ministrisë.

b. Departamenti për Mbrojtje dhe Integrim

Departamenti i negociatave dhe integritit është themeluar si njësi e veçantë organizative e Departamentit të Bashkimit Evropian dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar në vitin 2006, transformimin e ish-Departamentit për Integritime Evropiane. Krijimi i departamentit në fjalë ishte përgjigje e rritjes së nevojave që dalin nga intensifikimi i procesit të integritit të Maqedonisë në Bashkimin Evropian dhe arritjen e qëllimit strategjik të Republikës së Maqedonisë Veriut për anëtarësim në BE.

¹⁰ <https://mvr.gov.mk/profilepage/megjunarodna-sorabotka>

c. Departamenti për IPA

Përgjegjësia kryesore e Departamentit për IPA fonde është që të sigurojë mbështetje teknike për projektet e zbatuara në Ministrinë e Punëve të Brendshme në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA)¹¹

8.1.Europoli

Agjensia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunimin e Zbatimit të Ligjit, ndryshe Europol, është e projektuar për të ndihmuar në krijimin e një Europe më të sigurt duke mbështetur zbatimin e ligjit në luftën kundër krimeve të rënda të organizuar dhe terrorizmit. Europoli përdor informacionin e vet unik dhe kapacitetin analitik dhe ekspertizën e më shumë se 700 të punësuarve me qëllim të zbulimit dhe gjetjen e rrjeteve më të rrezikshme kriminale dhe terroriste. Europoli si një organizatë e inteligjencës përgjegjëse për zbatimin e ligjit kërkon mbështetje në përmirësimin e efikasitetit dhe bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve kompetente të Shteteve anëtare në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, terrorizmit dhe format e tjera të rënda krimi që përfshin dy ose më shumë Shtete Anëtare.

a. Europol ka këto detyra themelore:

- a. grumbullimin, ruajtjen, përpunimin, analizimin dhe shkëmbimin e të dhënave;
- b. njoftimet tek autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare për informacionin në lidhje me to dhe për çdo lidhje të zbuluar ndërmjet veprave penale;
- c. ndihmë në hetimet në Shtetet Anëtare, në veçanti duke ofruar të gjitha informatat relevante për njësitë kombëtare;
- d. referencat ndaj autoriteteve kompetente të Shteteve Anëtare të interesuara për të iniciuar, drejtuar ose koordinuar hetimet dhe propozimet për ngritjen e ekipeve të përbashkëta të hetimit në raste specifike;
- e. ofrimin e inteligjencës dhe mbështetjes analitike e Shteteve Anëtare në lidhje me çështjet kryesore ndërkombëtare;
- f. përgatitjen e vlerësimeve të kërcënimeve, analizave strategjike dhe raporteve të gjendjes së

¹¹ <http://cfcd.finance.gov.mk/wp-content/uploads/2015/07/Call-for-contribution.pdf>
<https://mvr.gov.mk/page/sektor-za-eu-i-megjunarodna-sorabotka>

përgjithshme lidhur me qëllimin e saj, duke përfshirë vlerësimet e kërcënimeve nga krimi i organizuar.

Përmirësimet e bashkëpunimit të vendit tonë me Europol-in në fushat me prioritet aktual, operacionet e përbashkëta dhe hetimet në vazhdim janë tashmë të dukshme.

Informacioni nga këto hetime i kthehet Europol-it përmes një sistemi të sigurt, SIENA, me qëllim që të analizojë dosjet e punës për analizën e Europol - Files Analysis Work Files AWFs.¹²

8.2. Interpoli

Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale - Interpol është organizata më e madhe ndërkombëtare e policisë, e cila përfaqëson 190 vende të botës (nga numri i anëtarëve, është organizata e dytë më e madhe botërore pas OKB-së).

Ajo u formua në vitin 1923 me qëllim lehtësimin e bashkëpunimit ndërkombëtar policor, dhe për të dhënë mbështetje dhe ndihmë për të gjitha organizatat, organet dhe shërbimet misioni i të cilëve është për të parandaluar dhe luftuar krimin ndërkombëtar.

Republika e Maqedonisë, në Asamblen e Përgjithshme të mbajtur në Aruba në vitin 1993 u bë anëtare e Interpolit, dhe u krijua NCB INTERPOL-Shkup, në përputhje me nenin 32 të Kushtetutës INTERPA.

Në kuadër të Njesisë NCB Interpol Shkup, punojnë policët-inspektorë, ku për qëllim kanë: zbulimin e vjedhjeve ndërkombëtar të automjeteve, trafikun e drogës dhe armëve, trafikimi me genie njerëzore, krimin financiar, krimet e dhunshme dhe terrorizmin, identifikimin e personave dhe verifikimin e dokumenteve.

Bashkëpunimi operativ me Interpol-in bëhet përmes shkëmbimit të informacionit me policinë, njohurive dhe të dhënave, dhe përmes pjesëmarrjes aktive dhe të vazhdueshme të ekspertëve të Ministrisë së Brendshme në grupet punuese të Interpol-it.

Në bashkëpunim me Sekretariatit e Përgjithshëm të Interpol në Lion Francë, Departamenti i Interpol BKT Shkup përfshihet në projekte të mbështetur dhe hetime të përbashkëta, bën shkëmbimin e informacionit, etj.

Prej vitit 2003, NCB Interpol Shkupi është e lidhur direkt me sistemin e informacionit I-24/7 Interpol përmes të cilave bëhet shkëmbimi i e-mail me NCBs-të e tjera, si dhe duke përdorur më shumë web - shërbimet që mundëson ky sistem, duke përfshirë qasjen e drejtpërdrejtë në bazat e

¹² <https://www.europol.europa.eu/agreements/republic-of-north-macedonia>

të dhënave kriminale qendrore të Interpol-it dhe nënshkrimin elektronik të mandateve ndërkombëtare. NCB Shkupi merr pjesë aktive në ushqimin e bazave të të dhënave globale me informacion mbi personat, automjetet, dokumentet, dhe objektet e artit.¹³

8.3.Selek

Qendra për Zbatimin e Ligjit në Europën Juglindore (Selek) është një agjenci ndërkombëtare për zbatimin e ligjit, e themeluar me një marrëveshje që bashkon burimet dhe ekspertizën e policisë dhe shërbimeve doganore që kombinojnë përpjekjet e tyre për të luftuar më efektivisht krimin e organizuar ndërkufitar në rajon.

Selek mbështet 11 shtete anëtare të saj, edhe Maqedonin në parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar dhe krimit transnacional.¹⁴

Aktivitetet operacionale të Slek kryesisht realizohen në kuadër të tetë grupeve operacionale që merren me çështje të lidhura me trafikimin e drogës dhe njerëzve, automjeteve të vjedhura, kontrabandës dhe mashtrimit doganor, krimit financiar dhe krimit kibernetik, terrorizmit, dhe krimin mjedisor dhe hapsinor.¹⁵

¹³ secili shtet anëtar duhet të caktojë një autoritet që do të veprojë si një pikë qendrore për bashkëpunimin ndërkombëtar të policisë brenda organizatës - ky organ është emëruar Byroja Qendrore Kombëtare (NCB) INTERPOL (zakonisht e emëruar pas kryeqytetit)

<https://mvr.gov.mk/profilepage/megjunarodna-sorabotka>

¹⁴ Zyrtari ndërlidhës i Ministrisë së Brendshme që nga shtatori i vitit 2007 ndërmerr aktivitete për avokim të Drejtorisë Doganore të Republikës së Maqedonisë në SELEC Aktualisht, ekzistojnë tetë grupe punuese, d.m.th. Grupe punuese: për shtypjen e përdorimit të drogës nga NT, për shtypjen e trafikimit të qenieve njerëzore dhe migracionin e paligjshëm, për shtypjen e krimit me automjete të vjedhura, për financiare dhe krimin kibernetikë, anti-terrorizmi, mashtrimet doganore dhe komerciale, dhe "Sigurimi i kontejnerëve" në të cilin marrin pjesë administratat doganore nga vendet anëtare të SELEK dhe një punë e re në grup për luftimin e krimit të drejtuar ndaj natyrës dhe mjedisit.

¹⁵ http://www.mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/%D0%A1%D0%95%D0%9B%D0%95%D0%9A.pdf

9. Qendra për trajnim

Në bazë të ndryshimeve që kanë ndodhur në Ligjin për Punë të Brendshme (neni 20-c i Ligjit për Punë të Brendshme ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 19/95, 15/97, 55/97, 38/02, 33/03 , 19/04, 51/05 dhe 84/08) në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Republikës së Maqedonisë u krijua Qendra e Trajnimit si njësi organizative.

Qendra e Trajnimit zhvillon trajnime themelore të policisë, trajnim të veçantë dhe trajnim për menaxhim në fushat e sigurisë të punonjësve të Ministrisë bazuar në rregulla dhe ligje.

Qendra për trajnim konsiderohet si një ndër pesë qendrat më të mira të trajnimit në Evropë.

Edukimi policor bazohet në një program që përmbush kriteret e cilësisë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, nga kjo kuptojmë se janë duke u përmbushur standardet e cilësisë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Kjo qendër përqendrohet në lehtësimin e arritjes së aftësive profesionale për kryerjen e aktiviteteve thelbësore në punë dhe funksionet në mënyrë të përshtatshme.

Kompetenca është aftësia për tu marr me aktivitetet thelbësore të punës dhe funksioneve në mënyrë të përshtatshme dhe bazohen në njohuri, shkathtësi, përvoja, qëndrime dhe sjellje personale.

Mësimet e fituara të të trajnuarve kontrollohen përmes testeve për matjen e kompetencave, përmes të cilave dëgjuesi ka nevojë për një situatë të vërtetë ose simulim, praktikisht për të treguar aftësitë.

Për këtë, qendra trajnon vlerësues të pavarur, oficerë policie nga të gjitha sektorët e MPB-së për aktivitet të caktuar, të cilët janë profesionistë në fushën e tyre. Kjo mënyrë e vlerësimit rrit objektivitetin dhe pavarësinë në vlerësim. Duhet të punohet në drejtim që Trajnuesit (mësuesit) në Qendrën e Trajnimit dhe trajnerët në terren (mentorët) në praktikë të lehtësojnë dhe rrisin trajnimin e punonjësve të rinj të policisë. Për të rritur trajnimin, trajnuesit duhet të jenë zyrtarë policorë kompetentë, edhe të kenë njohuri të caktuara në këtë drejtim.

Poashtu Trajnimi të zhvillohet edhe në praktikë, në vendin e punës në të ardhmen.¹⁶

Për më tepër, për t'i mundësuar nxënësve të mësojnë në mënyrë efektive, vetë trajnuesit duhet të zotërojnë aftësi të duhura pedagogjike. Qëllimi është që të krijohen policë kompetentë të cilët punojnë në mënyrë pro aktive dhe profesionale, duke respektuar kushtetutën, ligjet, të drejtat e

¹⁶ https://mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/SELEK.pdf

njeriut dhe diversitetin, policë që do rrisin besimin dhe do të shërbejnë për të gjithë qytetarët e Maqedonisë së Veriut.

Duke pasur parasysh se ndryshimi në mënyrën dhe stilin e punës së policisë nuk është aspak punë e lehtë dhe e thjeshtë sepse ndikohet nga një numër faktorësh, ky ndryshim duhet të konsiderohet më i gjatë, një proces i cili paraprinë nga përmbushja e disa parakushteve.¹⁷

10. Oficeri për mbrojtjen e të dhënave personale

Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është themeluar në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si një organ shtetëror i veçantë.

Drejtoria mund të kryejë hetime, të marr ankesa, të bëjë analizën e legjislacionit të propozuar dhe të promovojë të dhëna duke përfshirë trajnimin e qeverisë, si dhe institucionet dhe kompanitë private.

Misioni i Drejtorisë është të kryejë inspektime mbi ligjshmërinë e veprimeve të ndërmarra gjatë përpunimit të të dhënave personale dhe mbrojtjen e tyre në vend.

Drejtoria pasqyron standardet në Direktivën aktuale të BE-së dhe legjislacioni kombëtar për mbrojtjen e të dhënave.

Mbrojtja e të dhënave personale dhe privatësisë është e drejtë e pa cenueshme e çdo individ, e mbrojtur me Ligj dhe me Kushtetutë, ku garantohet mbrojtja, ruajtja dhe mosabuzimi me të dhënat personale të qytetarëve.

Mbrojtja e të dhënave duhet të shihet në dritën e të drejtës së privatësisë të mbrojtur nga Neni 25 i Kushtetutës dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Neni 8.

Bashkimi Evropian, ka miratuar Direktivën 95/46 / EC për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave.

Direktiva pritet të zëvendësohet nga një regjim i ri i mbrojtjes së të dhënave.

Kjo Drejtori ka marr mbështetje të vazhdueshme nga BE.¹⁸

¹⁷ Mirčeva, S., & Rajkovčevski, R. (2013). Policing in the Republic of Macedonia. In Handbook on Policing in Central and Eastern Europe (pp. 143-168). Springer New York.
<https://mvr.gov.mk/page/vizija>

¹⁸ The country has ratified the Additional Protocol to the Convention for the Protection of Individuals with regard to Automatic Processing of Personal Data, regarding supervisory authorities and transborder data flows. The convention requires that the supervisory authorities shall exercise their functions in complete independence (article5)

Kapitulli II

Kuadri Ligjorë i regullimit të sistemit të MPB-ës

1. Reforma Ligjore

Komisionit Evropian në gatishmëri për të punuar dhe mbështetur qeverinë e re të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë në përpjekjet e saj për reforma, ky komision ka kërkuar ekspertët e njëjtë të pavarur të ligjit të cilët e përgatitën raportin në vitin 2015, të bëjnë vlerësimin dhe përparimin në këtë proces reformues.

Në këtë kontekst, komisioni ftoi grupin punues të formulojë rekomandime për t'i mundësuar qeverisë së re dhe institucioneve të tjera që të zgjidhin mangësitë e vazhdueshme në disa fusha të sundimit të ligjit.

Në përputhje me misionin e saj në vitin 2015, grupi i ekspertëve u përqendrua në gjendjen e gjyqësorit, zbatimin e ligjit dhe ndjekjen penale, duke përfshirë sistemin e përgjimit dhe mbikëqyrjen, organet e pavarura dhe mbikëqyrjen e tyre.

Ky raport është i kufizuar në disa fusha të drejtuara nga ligji, por nuk do të thotë që reforma nuk kërkohen edhe në sfera tjera.

Disa informacione janë siguruar në besim, Prandaj edhe nuk zbulohen burimet e informacionit për secilën gjetje.

Megjithatë, grupi i ekspertëve ishte i kënaqur që secili nga informacionet e siguruar bazohet në informata faktike dhe materiale të mjaftueshme për të konfirmuar saktësinë e tyre.

Vendi jonë ka bërë disa përparime duke ndryshuar ligjet ekzistuese (ligjin për të huajt, kodin penal dhe ligjin mbi kontrollin kufitar) dhe miratimin e dokumenteve strategjike në disa fusha, por nuk do të thotë që nuk duhet akoma punë për përmisimin e kushteve jetësore.¹⁹

¹⁹ https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/2017.09.14_seg_report_on_systemic_rol_issues_for_publication.pdf
https://europa.eu/european-union/documents-publications_en

Ibrahim Ceka, Qasje mbi parimet e administratës publike, Shkup

2. Procedura e hartimit të ligjeve

Hartimi i ligjeve i nënshtrohet një procedure të caktuar legislative duke filluar nga propozuesi, miratimi dhe shpallja e tij në gazetën zyrtare si fazë përfundimtare për miratimin e ligjeve.

2.1. Ligjet e propozuara për Policinë

Ligjet e propozuara për Policinë kanë të bëjnë me, zgjidhjen për përcaktimin e Stacioneve Policore të qëndrueshme dhe profesionale, draft raporti për vlerësimin e ndikimit të rregullores së punës së policisë, projektligji për ndryshimin e ligjit për policinë, draft ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për policinë, propozim ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për punë të brendshme, projektligj për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për çështje të brendshme, ndryshim ligji për Agjencinë Teknike Operative, propozim ligji për monitorimin e komunikimeve, projektligji për mbrojtje ndërkombëtare, Kodi i Policisë, ligji për punë të brendshme, draft ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për armët, rregullat, lloji i teknikës që duhet të përdoret për audio dhe video incizim nga policia, draft raporti dhe projektligji për policinë.²⁰

3. Ligji për polici dhe aktet nënligjore

Kompetencat dhe burimet e policisë, prokurorisë publike, gjykatave dhe agjencisë për administrimin e pasurive të konfiskuara, akoma duhet të forcohet në mënyrë që të mund të konfiskojnë pasuritë e fituara në mënyrë të jashtligjshme.

Policia financiare dhe Njësia e Inteligjencës Financiare kanë burime dhe kapacitete të dobëta në

²⁰ Disclaimer: The views expressed in this document are those of the experts and the team leader and do not necessarily represent the opinion of the European Commission. The group has worked independently, without receiving instructions from any institution as to the contents of its report.
Independent Senior Experts' Group, The former Yugoslav Republic of Macedonia: Recommendations of the Senior Experts' Group on systemic Rule of Law issues relating to the communications interception revealed in Spring 2015, 8 June 2015,
https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news_corner/news/news_files/20150619_recommendations_of_the_senior_experts_group.pdf
<http://meta.mk/wp-content/uploads/2017/09/predlog-zakon-za-izmeni-na-zakonot-za-policija-2017.doc>

luftën kundër krimit të organizuar, vendosja institucionale dhe shtrirja ligjore, ndryshimet e reja të Kodit Penal që u miratuan në dhjetor 2015, duke futur dënimet më të rënda për veprat penale që lidhen me shfrytëzimin e të miturve. Një pjesë e rëndësishme e ligjit për procedurën penale janë qendrat hetimore të destinuara për të institucionalizuar bashkëpunimin ndërmjet prokurorëve dhe policisë.

Ligji për ngrirjen, konfiskimin dhe menaxhimin e pasurive kriminale duhet të përmirësohet, duhet të forcohet statusi ligjor dhe funksionet e Agjencisë për Menaxhimin e Pronës së Konfiskuar.

Përkundër ndihmës së ekspertëve të BE-së, ligji për përgjimin e komunikimeve ende nuk është ndryshuar për ta sjellë atë në përputhje me standardet Evropiane.

Strategjia e zhvillimit të policisë 2016-2020 u miratua në janar 2016, ky model parasheh një polici proaktive në luftën kundër krimit.

Legjislacioni kundër pastrimit të parave është përmirësuar, por nevojiten ndryshime shtesë për të siguruar pajtueshmëri të plotë me *acquis*.

Administrata doganore, policia financiare dhe policia kufitare janë aktorët kryesorë në luftën kundër krimit të organizuar, por nevojitet qartësia për ndarjen e kompetencave të tyre përkatëse. Bashkëpunimi i intensifikuar dhe shkëmbimi i inteligjencës me autoritetet doganore të vendeve fqinje dhe rajonit më të gjerë.

Komisioni Kombëtar për Luftimin e Trafikimit dhe Migracionit të Paligjshëm ka funksionuar që nga viti 2001 si një organ koordinues ndërministror për të monitoruar dhe analizuar trafikimin në vend.

Zyra e Mekanizmit Kombëtar të Referimit vepron në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale dhe siguron ndihmë dhe mbrojtje të koordinuar për viktimat e trafikimit, veçanërisht gratë dhe fëmijët.

Strategjia e sigurisë kibernetike ende nuk është finalizuar dhe duhet të përafrohet me Strategjinë Evropiane të Sigurisë Kibernetike.

Një seksion i ri mbi krimin kibernetik u krijua në Njësinë e Ministrisë së Brendshme për Punë të Brendshme.

Ministria e Brendshme poashtu ka disa njësi mjeko-ligjore, duke përfshirë identifikimin biologjik dhe të ADN-së.

4. Hetime

Hetimet e filluara u iniciuan nga përgjimi ilegal, dhe filluan në janar të vitit 2015, nga Prokuroria Themelore Publike për Prokurorinë e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionin kundër 7 individëve, që besohet të jenë direkt ose indirekt përgjegjës për përgjimet e paligjshme dhe për shpërndarjen e atyre komunikimeve të përgjuara.

Disa janë akuzuar për ndalim të paligjshëm (neni 151 i Kodit Penal), të tjerë me spiunazh (neni 316 i Kodit Penal) dhe të tjerë për dhunë ndaj një përfaqësuesi të një institucioni të lartë (neni 311 i Kodit Penal).

Grupi i punës i formuar nga ekspertë Evropian, informoi se hetime të mëtejshme janë iniciuar ose janë planifikuar në lidhje me zbulimin aktual të sjelljes kriminale që dolën nga publikimi i përgjimeve.

5. Ligj për Ndryshimin e Ligjit për Punë të Brendshme

Me ndryshim dhe plotësimin e ligjet për Punë të Brendshme synohet të arihet një polici profesionale e cila do të ndjek shembuj nga policitë e shteteve më të zhvilluara dhe do të punojë në përputhje me standardet Evropiane.²¹

Ligje e ndryshuara hynë në fuqi ditën e tetë (8) nga dita e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë Veriut.

Ligj për policinë i rregullon punët e brendshme, parimet e përgjithshme për punëtorët në Ministrinë e Brendshme, organizimin dhe kompetencat e Ministrisë, statusin, detyrat dhe kompetencat e veçanta të punonjësve, klasifikimin e vendeve të punës, bashkëpunimin, kontrollin mbi kryerjen e detyrave në Ministri, përgjegjësit materiale, kompensimin e dëmeve dhe përgjegjësia disiplinore e punonjësve në Ministri, si dhe përpunimin e të dhënave personale. Gjatë kryerjes së detyrave punonjësit në Ministri mbajnë standarde të larta të integritetit personal, etikës profesionale dhe kujdesit për mbrojtjen e interesit publik dhe respektojnë aktet që rregullojnë këto standarde.

²¹ <https://mvr.gov.mk/Upload/Documents/2.%20ZVR%20116-14.pdf>
<https://mvr.gov.mk/Upload/Documents/3.%20ZVR%2033-15...pdf>
<https://mvr.gov.mk/Upload/Documents/5-2016.pdf>

Punonjësit e Ministrisë në kryerjen e detyrave dhe punëve të tyre sigurojnë zbatimin e paanshëm dhe objektiv të ligjeve dhe rregulloreve të tjera, me anë të së cilës qytetarët dhe personat juridikë sigurojnë mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave dhe kjo nuk lë vend për paragjykim nga qytetarët dhe personat juridikë të tjerë, dhe as nuk është në kundërshtim me interesin publik, të përcaktuar me ligj.

Punëtorët në Ministri punojnë dhe kryejnë detyrat e tyre të punës në mënyrë të paanshme politike, pa paragjykuar besimet e tyre politike dhe interesat personale financiare.

Punonjësit duhet të respektojnë qëllimet, interesat, reputacionin dhe integritetin e Ministrisë, në kryerjen e detyrave të tyre, të sigurojnë qasje në informata me karakter publik me të dhënat e tyre personale dhe informacionin e klasifikuar, poashtu duhet të veprojnë në përputhje me kushtet e përcaktuara me ligj.

Një punëtor në Ministri nëse është nevoja ka të drejtë dhe obligim ligjorë që gjatë vitit të trajnohet në përputhje me nevojat e Ministrisë dhe në bazë të planit individual të zhvillohet profesionalisht. Pas përfundimit të trajnimit, i punësuarit është i detyruar të transferojë njohuritë e fituara tek punonjësit e tjerë.

Punëtorët obligohen t'i përgjigjen Ministrisë për pasojat e veprimeve të tyre, mosveprimet apo vendimmarrjes, si dhe kryerjen e cilësisë, kohës dhe efikasitetit të detyrave të besuara.

Mjetet e punës dhe pasurit e tjera të ministrisë përdoren në mënyrë ekonomike, të arsyeshme dhe efikase.

Neni 2 për Punë të Brendshme përcakton detyrat e të punësuarve.

- Realizimi i sistemit të sigurisë publike dhe shtetërore;
- Parandalimin e prishjes së dhunshme të institucioneve demokratike të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Mbrojtja e jetës, sigurisë personale dhe pasurisë së qytetarëve;
- Parandalimin e shkaktimit të urrejtjes dhe intolerancës kombëtare, racore ose fetare;
- Parandalimin e kryerjes së veprave penale dhe kundërvajtjeve, zbulimin dhe kapjen e autorëve të tyre dhe marrjen e masave të tjera të parashikuara me ligj për ndjekjen penale të kryerësve të këtyre veprimeve;
- Punët civile dhe Aktivitete të tjera të përcaktuara me këtë dhe ligj të veçantë.²²

²² ibid

5.1. Ligji për përcjelljen e komunikimeve

Kodi penal i Maqedonis së Veriut është kryesisht në përputhje me standardet Evropiane. Ligji për procedurën penale u modernizua në vitin 2010.

Ligji për përgjimin e komunikimeve i vitit 2006, është ndryshuar në vitin 2012, por Prioriteti Urgjent i Reformës, rekomandon ndarjen e mandatit, rregulloreve dhe pajisjeve teknike për përgjimin në hetimet penale nga ata për qëllime të sigurisë dhe zbulimit.

Policisë, administratës doganore dhe policisë financiare duhet tu jepen mjete teknike për të kryer përgjime pa u mbështetur në shërbimet e inteligjencës.

5.2. Ligji për kontroll ndërkufitar dhe aktet nënligjore

Në legjislacionin e Maqedonis së Veriut, e drejta kushtetuese për azil, të cilën e garanton kushtetuta për të huajt dhe personat pa shtetësi në mërgim, rregullohet me Ligjin për Azil dhe Mbrojtje të Përkohshme.

Megjithatë, situata me numrin e emigrantëve të paligjshëm që kalojnë nëpër territorin e vendit tonë viteve të fundit u rritur shumë. 2012-2016

Edhe pse destinacion i fundit i emigrantëve nuk është vendi jonë, janë shtet e pasura Evropiane, por bukur shumë u ritë pasigrura dhe trafikimi ilegal njerëzor.

Problemet që lidheshin me valën e emigrantëve të paligjshëm janë veprat penale që lidhen me kontrabandën, rrjedhimisht ka një rritje të krimit në lidhje me sulmet kundër emigrantëve.

Në këtë kontekst, për të parandaluar dhe kapërcyer situatat me emigrantë e paligjshëm dhe duke marrë parasysh pajtueshmërinë me konsistencën e deklaruar në politikën e migracionit, është ndryshuar Ligji për Azilin dhe Mbrojtjen e Përkohshme.

Përkatësisht, zgjidhjet e propozuara ligjore bëjnë dallimin midis qëllimit, paraqitjen e kërkesës për njohjen e së drejtës për azil nga azilkërkuesit e mundshëm.

Zgjidhja e propozuar normative lejon që një i huaji në pikën e kalimit kufitar ose brenda territorit të Republikës së Maqedonisë Veriut, të deklarojë synimin e tij, punonjësi i policisë të paraqesë një kërkesë për njohjen e së drejtës për azil, të cilën ai e drejton brenda 72 orëve tek një zyrtar i autorizuar i Departamentit të Azilit në ambientet e Qendrës së Pritjes për azilkërkuesit.

Qëllimi i ligjvënësit, është të lehtësojë qasjen e azil kërkuesve të mundshëm në procedurën e

azilit, si dhe të parandalojë migracionin e paligjshëm. Gjithashtu, në projektligj janë paraparë vendet në të cilat azilkërkuesi mund të aplikojë për njohjen e së drejtës për azil, kërkesa për njohjen e së drejtës për azil mund të paraqitet në polici në pikën kufitare, stacionin më të afërt të policisë ose në ambientet e Departamentit të Azilit.

Me këto ndryshime ligjore priten tre përfitime të rëndësishme, së pari, siguri më të madhe dhe zvogëlimin e rreziqeve ndaj emigrantëve, aplikuesit për azil do marrin një dokument që mund të lëvizin ligjërisht, dhe nuk do të rrezikojnë jetën e tyre në hekurudha dhe rrugë. Së dyti, shkalla e kriminalitetit do të reduktohet duke pasur parasysh faktin se ata mund të lëvizin ligjërisht, nuk do të kenë nevojë të krijojnë kontakte me grupe të dyshimta që më vonë do të keqpërdorin pozicionin e tyre. Së treti, policia do të marr shënime shumë më adekuate për njerëzit që hyjnë në territorin tonë.²³

²³ <https://mvr.gov.mk/vest/155>

<https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Zakon-za-vnatreshni-raboti-03-03-2014.pdf>

<http://www.mvr.gov.mk/Upload/Documents/Zakon%20za%20policija.%20precisten%20tekst%2015.04.2015%20.pdf>

Kapitulli III

Roli i Bashkimit Evropian në Reforma

1. Përgjegjësia dhe marrja e këshillave

Të gjitha institucionet në vend kanë për detyrë të marrin përgjegjësitë e tyre përkatëse dhe të kryejnë detyrat e tyre. Bashkimi Evropian, bashkësia ndërkombëtare si dhe vendet dhe institucionet Evropiane janë në gatishmëri që vendit tonë t'i ndihmojnë dhe japin këshilla, siç kanë bërë edhe në të kaluarën.

Megjithatë, përgjegjësia për të adresuar shkeljet dhe për të bërë progres është me institucionet e vendit.

2. Promovimi i vlerave evropiane

Me ngecjen e reformave të filluara menjëher pas publikimit të përgjimeve, Grupi i Ekspertëve Evropian, përsëriti atë që theksoi në raportin e vitit 2015.

Demokracia, barazia dhe respektimi i të drejtave të njeriut dhe sundimi i ligjit janë ndër vlerat themelore në të cilat është themeluar Bashkimi Evropian. Prandaj respektimi i rreptë i këtyre vlerave është thelbësor për një vend kandidat.

Të gjitha segmentet e shoqërisë, duke përfshirë të gjitha grupet parlamentare, institucionet publike, mediat dhe shoqërinë civile, kanë një rol të rëndësishëm në adresimin e çështjeve të ngritura në raportin e Brukselit, dhe për të ndihmuar në rikthimin e procesit të reformës së vendit në rrugën e duhur.²⁴

3. Përafrimi i legjislacionit me atë të UE-së

Një kërkesë shumë e rëndësishme e UE-së është inkorporimi i sistemit *acquis* në legjislacionin kombëtar, si dhe zbatimi i tij efektiv, pra rritja e kapaciteteve implementuese dhe përforcuese,

²⁴ Mr.sc.Sadik Zenku, Institucionet e Bashkimit Evropian dhe procesi i integritit të Maqedonisë në Bashkimin Evropian, Kërçovë, 2013
E.Aziri, N.Maliqi, A.Pajaziti, Proceset e Integritit Euroatlantik dhe Republika e Maqedonisë, Tetovë, 2008

përmes strukturave të duhura administrative dhe atyre të drejtësisë.

Në lidhje me këtë shteti jonë gjindet përballë dy sfida, së pari, të sigurojë përafrimin e legjislacionit të saj me ligjet e UE-së dhe, së dyti t'i zbatojë ato me efektivitet. Institucionet e vend akoma nuk janë në nivelin e kërkuar për arritjen e synimit të përafrimit legjislativ me të acquis.

4. Maqedonia dhe hapësira administrative Evropiane

Maqedonia Veriore i filloi reformat e administratës publike (para së gjithash konstituivën e pushtetit ekzekutiv në bazë të neneve të kushtetutës së vitit 1991), nëpërmjet vendosjes së strategjisë për reforma të administratës publike në shtet.

Ku edhe sot e kësaj dite në shtetin tonë reformat vazhdojnë dhe janë të nevojshme për përmirësimin e jetës së qytetarëve.

4.1. Si të përshpejtohen hapat drejt procesit të integrimit ?

Zhvillimi dhe integrimi i vendit duhet të shkojë përmes zgjedhjeve të lira, luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, sigurisë së kufijve, shtetit ligjor, tregut të lirë, demokracisë funksionale, dhe respektimi i barazive etnike.

Zhvillimet e ngadalta dhe kontradiktore në vitet e fundit erdhi deri te instalimi i sistemit të korrupsionit, toleranca ndaj krimit dhe lidhja e tij me politikën, kapja e shtetit, mungesa e zgjedhjeve të lira e demokratike, u bënë pengesa dhe arsyeja kryesore e ngadalësimit të procesit integruar të vendit në strukturat euroatlantike.

5. Zhvillimi i Sigurisë

Termi Komuniteti i Sigurisë në fjalorin e Kriminologjisë (2001) është përshkruar si një strategji që kërkon përfshirjen e shumë subjekteve nga komuniteti (duke përfshirë edhe policinë) për të rritur sigurinë e saj jo vetëm nga kryerja e krimeve, por edhe nga dëmet e shkaktuara nga të gjitha fushat.

Komuniteti i sigurisë trajton efektet e dëmshme të krimit dhe varet nga aftësitë e vetë qytetarëve që jetojnë në të për të vepruar dhe reaguat.

Në Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (United Nations Development Program (UNDP), komuniteti i sigurisë përfshin sigurinë individuale dhe kolektive, pra qytetarët dhe komuniteti të jetë i lirë nga frika.

Në një shoqëri demokratike, puna e policisë konsiston në respektimin e sundimit të ligjit dhe vlerave të tij përkatëse.

Një parakusht për këtë është depolitizimi i Policisë, një polici llogaridhënëse dhe transparente për publikun, e cili është e fokusuar në ofrimin e shërbimeve ku vëmendja është në parandalimin proaktiv të krimit.

Në një shoqëri demokratike, policia si prioritet në punën e tyre kanë nevojat e qytetarëve dhe të shtetit. Në ushtrimin e kompetencës së saj ligjore, policia duhet të jetë pjesë e një përpjekjeje të përbashkët sociale për të mbrojtur legjitimitetin dhe për të përmirësuar sigurinë.²⁵

6. Marrëveshja për Stabilizim Asocim

Në Maqedoni, policia është pjesë e dokumenteve strategjike të Qeverisë, duke filluar nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocialit ndërmjet Maqedonisë dhe Bashkimit Evropian (2001), të Marrëveshjes në kuadër të 08/13/2001, Strategjisë kombëtare për integrimin e Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian më 6 shtator 2004.

Idetë dhe rekomandimet që dolën nga këto procese gjetën shprehjen e tyre normative në strategjitë për reformën e policisë në vitin 2003, ligji i ri për policinë, ligji për punë të brendshme dhe planet strategjike të Ministrisë së Brendshme të miratuar çdo dy vite.

Ato u iniciuan dhe u mbështetën në kuadër të programit CARDS të Bashkimit Evropian dhe përmes projekteve të binjakëzimit në të cilat reformat policore u standardizuan në fushën e Drejtësisë dhe Punëve të Brendshme.

Qëllimi kryesor i reformave është krijimi i një shërbimi policor efektiv, publik dhe shikimi i policisë si një shërbim në funksion të qytetarëve.²⁶

²⁵ E.Aziri, J.Abdullai, A.Pajaziti, M.Memeti Shteti i së drejtës dhe reformat në administratën publike: Rasti Maqedonia, fq. 128,129

²⁶ Artan Ibrahim, Integrimi i Ballkanit Perëndimor në UE, Shkup 2009

Përveç qëllimeve të tjera specifike, një aspekt i rëndësishëm është vendosur në ndërtimin e partneriteteve me qytetarët në mënyrë që të rritet besimi i tyre në polici, zvogëlimi i frikës nga krimi dhe rritja e sigurisë së qytetarëve.

Qëllimi dhe programi për ndërtimin e një partneriteti midis policisë dhe qytetarëve është një pjesë integrale dhe e përhershme e planeve strategjike të Ministrisë së Punëve të Brendshme në fushën e sigurisë publike.

Plani i fundit strategjik për periudhën 2014-2016, ishte ndërtimi partnership, marrëdhëniet qytetar – polici.

Mund të themi se Ministria e Punëve të Brendshme po bën disa përpjekje të caktuara për të zbatuar qëllimet dhe aktivitetet strategjike të parashikuara për të rritur bashkëpunimin e tyre të ndërsjellë, për të rivendosur besimin e qytetarëve në polici dhe për të përmirësuar sigurinë e qytetarëve.

7. Qendra Kombëtare Koordinuese për Parandalimin e Krimin të Rëndë dhe të Organizuar

Kjo qendër u themelua në vitin 2014, por deri në shtator 2017 nuk janë ndërmarrë aktivitete për zbatimin dhe funksionimin e saj.

Duke marr një sërë masash dhe aktivitete në përputhje me një plan veprimi që përfshihen në vete, Ministria e Brendshme, Drejtoria doganore, Policia Financiare, Njësia e Inteligjencës Financiare, Zyra e të Ardhurave Publike dhe të prokurorit publik, hapësirën e dhënë administrative, materiale dhe kushteve teknike që qendra të bëhet operacionale.

Qendra do të veprojë si një urë për informacionin dhe të dhënat që ata mbajnë, dhe mbledhin institucionet që sa më shpejtë të jenë në dispozicion për institucionet e tjera të përfshira.

Qendra filloi me mbështetjen e shkëmbimit ndërkombëtar të informacionit në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar të policisë, i cili është një segment i rëndësishëm në luftën e krimin të organizuar dhe transnacional.

Fillimi i kësaj qendre vjen në një periudhë shumë të rëndësishme për vendin, kur të gjitha përpjekjet e shtetit janë investuar në ofrimin e reformave sa më cilësore që do të ofrojnë të ashtuquajturat. 'Track-record', d.m.th. shembuj të qartë për zbatim të reformave.

Projekti për parandalimin e krimeve të rënda në Ballkanin Perëndimor, si dhe mbështetje financiare për hartimin e fondeve nga IPA 2020, nëpërmjet të cilit do të sigurohen fonde për këtë

organ koordinues dhe në përgjithësi për luftën kundër krimit të organizuar dhe transnacional.²⁷

8. Operacionet Politike dhe Parandalimi i Kriminalitetit

Duke ditur se parandalimi i krimit është një proces dinamik që përfshin tërësinë e masave dhe aktiviteteve që synojnë reduktimin e krimit, pasojat e saj, viktimat e krimit, dhe për të hequr ose zbutur shkaqet dhe faktorët e rrezikut që çojnë në krim dhe sjellje të tjera devijante, atëherë policia është një nga mekanizmat që në mënyrë aktive merr pjesë në proces.

Për rëndësinë e saj dhe shkallën e përfshirjes si pjesë e qasjes multisektoriale ndaj parandalimit të krimit, në literaturë vërehen qëndrime më profesionale, varësisht nga qasja dhe qëllimi drejt të cilit janë drejtuar masat parandaluese.

Në këtë kuptim, ndarja e parandalimit social dhe institucional është themelore, nëse pranojmë qasjet parandaluese të OKB-së, policia është gjithashtu pjesë e parandalimit të krimit.

Kjo qasje përqendrohet në parandalimin e kriminalitetit, identifikimin e shkaqeve dhe faktorëve të rrezikut dhe zgjidhjen e problemeve të qytetarëve.

Duke pasur parasysh më sipër, ne mund të pajtohemi se policia ka një rol si bartës, por gjithashtu ka një partner dhe bashkëpunëtor (qytetarët në zbatimin e masave parandaluese për parandalimin e krimit). Në këtë kuptim, roli i policisë nuk përcaktohet vetëm nga qasja reaktive në kryerjen e detyrave themelore policore të përcaktuara me Ligjin për Policinë, të cilat janë mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, mbrojtjen e jetës, sigurisë dhe sigurin e pronës së qytetarëve, ruajtjen e rendit publik, zbulimin e veprave penale dhe të autorëve.

Rrjedhimisht, roli i policisë nuk kufizohet vetëm në fuqinë policore të përcaktuara me ligj, por kërkon pjesëmarrje proaktive në realizimin e konceptit të parandalimit të krimit.

Kjo është e mundur vetëm përmes bashkëpunimit me qytetarët, por roli i tyre nuk duhet të shihet

²⁷ Изработила Розалита Дојчиновска, отсек за превенција и ПСОН-СВР Скопје, 2013.

Во последните неколку години, во рамките на програмата Соработка меѓу граѓаните и заедницата се спроведоа низа

проекти од кои ги издвојуваме: „Без толеранција за алкохол и дрога,,, „Да ги заштитиме шумите од пожари,,, „Вози мотор,но биди безбеден,,,„Безбедно користење на интернет,,, „Безбедни матурски и полуматурски прослави,,, „Злоупотреба на дрога и алкохол и превенција на трговија со деца, „Сите заедно за безбедно лето,,, „Девијантни однесувања на малолетници,,,„Против насилството во училиштата,, и низа други проекти и кампањи на локално ниво.

Дојчиновска, Р. (2013). Основи на превентивно полициско работење, Отсек за превенција и ПСОН-СВР Скопје.

Бачановиќ, О., Батиќ, Д., Мирчева, С. Стојковска, В.& Просароска, Ж. (2010). Прирачник за полициско постапување со деца, Факултет за безбедност, Скопје.

<https://mvr.gov.mk/vest/8722>

si burim informacioni ose si qytetarë të dëmtuar të cilët kanë nevojë për ndihmë të menjëhershme. Në këtë mënyrë, realizohet parimi i përgjegjësisë së përbashkët sociale në parandalimin e kriminalitetit.²⁸

9. Mbështetja e BE-së për Maqedoninë

a) Policia e rendi publik

Në këtë fushë policisë i janë ofruar këshilla strategjike, trajnime dhe pajisje të nevojshme për punët policore. Forcat policore kanë rolin themelore në forcimin e shtetit ligjor, sigurin e brendshme dhe luftën kundër krimit dhe korrupsionit.

b) Doganat

Misioni i ndihmës për Doganat, i cili veproi në mënyrë aktive për një kohë të caktuar ka arritur rezultate të vlefshme përsa i përket vjedhjes së të ardhurave, parandalimit të kontrabandës, korrupsionit dhe përmirësimin e menaxhimit të procedurave të doganave.

c) Demokracia dhe të drejtat e njeriut

Bashkimi Evropian ofron asistencë për organizatat që veprojnë në fushën e demokracisë dhe të drejtave të njeriut. Projektet mund të përfshijnë ndërgjegjësimin për rolin e të drejtave të njeriut në ndërtimin e shoqërisë civile, mbështetjen e programeve të mediave që promovojnë mirëkuptimin dhe tolerancën, riintegrimin e viktimave të trafikimit, etj.²⁹

²⁸ Дојчиновска, Р. (2013). Основи на превентивно полициско работење, Отсек за превенција и ПСОИ-СВР Скопје, стр. 10.

²⁹ Raik, K. (2004) "EU Accession of Eastern and Central European Countries: Democracy and Integration as Conflicting Logics" East European Politics and Societies. 18, fq 22

9.1. Nato

Maqedonia e Veriut është aktualisht në proces të pranimit në Organizatën e Traktatit të Atlantikut Verior (Nato) si një shtet anëtar, ku në vitin 1995, vendi u bashkua me Partneritetin për Paqe.

Në Samitin e Bukureshtit të vitit 2008, por Greqia vuri veton ndaj ftesës së vendit për t'u bashkuar, megjithatë, vendet e Nato-s ranë dakord se vendi do të merrte një thirrje për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së emrit të Maqedonisë.

Pas marrëveshjes së qershorit 2018 për të riemërtuar vendin, përfaqësuesit e përhershëm në Nato të shteteve anëtare më 6 shkurt 2019 nënshkruan një protokoll mbi pranimin e Maqedonisë Veriore në Nato.

Ministria e Brendshme, si organ i administratës shtetërore dhe ekzekutivit përgjegjës për realizimin e sigurisë publike dhe shtetërore ka bashkpunim edhe me Nato-n, në luftën kundër krimit të organizuar dhe transnacional.

Planet për bashkëpunimin e Ministrisë së Brendshme në aktivitete që lidhen me vendet anëtare të Nato-s, në fushën e sistemit të sigurisë kolektive nga ana e Ministrisë janë, aktivitetet e menaxhimit kombëtar dhe ndërkombëtar të krizës, përgatitjen e një perimetri kyç paqeruajtës të udhëhequr nga organizatat ndërkombëtare, bashkëpunimi ushtarak, civil dhe të tjerët.

Me rëndësi të veçantë në funksionimin e Regjistrimit të informacionit të huaj të klasifikuar përgjegjës për pranimin, regjistrimin dhe shpërndarjen e informacionit të huaj të klasifikuar të cilat sigurohen përmes shkëmbimit të informacionit të klasifikuar ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe shtetit të huaj apo organizatës ndërkombëtare. Regjistri për informacionin e klasifikuar të jashtëm gjithashtu kryen aktivitete brenda kompetencave të Drejtorisë për Sigurimin e Informacionit të Klasifikuar, përmes të cilit kryhet shkëmbimi i informacionit të klasifikuar me vendet e huaja dhe organizatat ndërkombëtare.³⁰

³⁰ https://en.wikipedia.org/wiki/Accession_of_North_Macedonia_to_NATO
<https://mvr.gov.mk/page/nato>

9.2. Unioni Evropian

Grupi punues i Bashkimit Evropian, ka bërë rekomandime dhe komente të cilat janë dizajnuara për të kaluar situatën e krizës politike duke ndërmarrë veprime konkrete. Ato u drejtohen organeve dhe institucioneve të ndryshme në vend, si dhe të gjithë aktorëve politikë, si në qeveri ashtu edhe në opozitë.

Disa rekomandime i referohen ndryshimeve të nevojshme në ligj, shumica e tyre kanë të bëjnë me veprimet dhe zgjedhjet brenda kornizës ekzistuese kushtetuese dhe ligjore.

Këto reforma urgjente duhet të lexohen së bashku me rekomandimet e grupit të ekspertëve, që kanë të bëjnë me ndjekjen e komunikimeve të përgjuara që u zbuluan në vitin 2015.

Rreforma të cilat do ta drejtojnë vendin drejt aspiratave të shteteve Evropiane dhe Demokratike, Nato dhe Bashkimit evropian.

Bashkëpunimin me vendet e rajonit, luftimin e migracionit, luftimi i pastrimit të parave, dhe çdo gjë tjetër në kundërshtim me ligjet në fuqi.

Forcimi i kapaciteteve të planifikimit strategjik brenda Ministrisë së Brendshme dhe Prokurorisë Publike duhet të forcohen për luftën kundër krimit.

Sa i përket mbrojtjes së të drejtave të njeriut, nevojiten përpjekje shtesë në praktikë për të siguruar respektimin e të drejtave të njeriut, duke përfshirë këtu refugjatët dhe emigrantet.³¹

³¹ Ibid

https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/2017.09.14_seg_report_on_systemic_rol_issues_for_publication.pdf

Kapitulli IV

REFORMAT BRENDA MPB-ës

1. Sistemi i Sigurisë në Maqedoni

Reforma e sektorit të sigurisë në Republikën e Maqedonisë dhe vendet e tjera të Ballkanit varen nga ndihma e bashkësisë ndërkombëtare, në përputhje me dëshirën për anëtarësim në NATO dhe BE dhe pranimin e normave dhe standardeve ligjore euroatlantike të sigurisë.

Përndryshe, nga pavarësia e Republikës së Maqedonisë, reforma policore është një nga çështjet themelore ligjore dhe politike në ndërtimin e parlamentit demokratik. Në thelb reforma, nga një aspekt i përkohshëm mund të jetë analizuar në disa periudha: nga viti 1991 deri në vitin 2001, nga kushtetuta, ndryshimet në vitin 2001, deri në miratimin e ligjit të ri penal në vitin 2010 dhe nga viti 2010 deri në ditët e sotme.

Megjithatë, reforma gjithëpërfshirëse e policisë në vendin tonë filloi në vitet 2002-2003 me ndihmën e përfaqësuesve të policisë nga vendet e Bashkimit Evropian, të cilët e kanë miratuar Strategjinë e Reformës së Policisë dhe Planin e Veprimit për zbatimin e tij. Brenda këtyre aktiviteteve në vitin 2008 janë ngritur departamentet për parandalimin e krimit në polici dhe u zhvillua trajnimi i oficerëve të policisë për të kryer detyrat parandaluese të krimi.

Pika fillestare për përmirësimin e sistemit të sigurisë në Republikën e Maqedonisë duhet të jetë, para se gjithash, përkufizimi i saj, si dhe përkufizimi i kushteve të veçanta që sistemi do të bëjë. Duke filluar nga rendi kushtetues i vendit tonë, një shtet i paqes, sundimit të ligjit, stabilitetit ekonomik, sigurimit social dhe mbrojtjes së mjedisit dhe vlerave të shoqërisë dhe qytetarëve duhet të jetë nënë sigurinë e Republikës së Maqedonisë Veriut.³²

³² http://www.eurm.edu.mk/publikacii/Zborik_Bezbednost_2012_1.pdf

Rade Rajkovčevski, Ndërtimi i politikës së sigurisë: Rasti i Republikës së Maqedonisë, Shkup
Закон за изменување и дополнување на Законот за внатрешни работи СВРМ бр.35/10; Исправка на Законот
за внатрешни работи СВРМ бр.118/09.

1.1. Raportimi i krimit në Republikën e Maqedonisë (2008-2013)

Për analizën e krimit të raportuar gjatë periudhës prej 6 vitesh, të dhënat në dispozicion janë raporte statistikore të Entit Shtetëror për Statistikë (për shkelësit) dhe statistika të caktuara në faqen e internetit të Ministrisë së Brendshme, të RM-ës.

Edhe pse krimi nuk është statistikë dhe nuk është vetëm një shifër, megjithatë, shifrat e paraqitura i referohen krimit të raportuar, i cili nuk reflekton shifrën e krimit.

Nëse shihet statistika e Entit Shtetëror të Statistikave, numri total i rasteve të raportuara penale në Prokurorinë Publike tregon një trend të rritjes së krimit të kryer nga të rriturit, ndërkohë që ka një tendencë të lehtë rënës në krimin e mitur. Krahasuar me statistikat e Prokurorisë Publike dhe statistikave gjyqësore, statistikat e policisë tregojnë se numri i krimeve të raportuara në polici është vazhdimisht më i madh se numri i shkelësve në 5 vitet e fundit (28.489 raste penale të raportuara kundër 17.678 kryerësve të raportuar në vitin 2010, 29.939 vepra penale të raportuara kundër 18.702 autorëve në vitin 2013) që do të thotë se një numër autorësh janë kryerës të disa veprave penale.

Në të kundërt, shërbimet MI kanë regjistruar rënie në krimin e të miturve në vitet e fundit, shifrat tregojnë se numri i të miturve është më i lartë se numri i veprave penale të regjistruara. Pra, krimi i të miturit karakterizohet nga performanca grupore e veprave. Arsyeja kryesore për zhvillime të tilla gjendet në kushte të pafavorshme ekonomike.

Problemi i vjedhjeve dhe abuzimi me drogat ka dimensionin e tij etiologjik në dështimin e shoqërisë për të ofruar ndihmë dhe mbështetje adekuate për qytetarët e tillë.

Konfliktet ndëretnike janë të motivuara politikisht dhe deri sa të arrijnë një konsensus politik dhe shoqëror për çështje të caktuara që janë të rëndësishme për jetën e të gjithë qytetarëve në vend do të organizohen protesta dhe incidente ndëretnike.

Duke pasur parasysh se konfliktet ndëretnike, dhuna e ndalesa e autobusëve, dhuna në shkollë, janë të mbuluara nga mediat, mund të gjejmë një lidhje të caktuar midis pjesëmarrjes së mediave në krijimin e një imazhi publik të krimit.³³

³³ http://www.eurm.edu.mk/publikacii/Zborik_Bezbednost_2012_1.pdf

Koncepti i integritit të sektorit të sigurisë është një element kyç i kësaj faze të reformës dhe i nevojshëm për të bashkuar të gjitha definicionet e ndryshme të sigurisë, mjedisit të sigurisë, sektorit të sigurisë, menaxhimit të sektorit të sigurisë (duke përfshirë çështjet e transparencës, vlerësimin e opsioneve, kontrolli civil, etj.)

Koncepti i integritit është një fazë e rëndësishme e reformave të mbrojtjes, në polici, në çështjet e jashtme (diplomaci), në mbrojtjen civile, në reformat e forcave speciale, në koordinimin dhe integrimin e tyre.

Për këtë koncept duhet të ndjekim programe për modernizimin e sektorit të sigurisë dhe zhvillimit, shkencës dhe teknologjisë, me implikime për ekonominë kombëtare dhe vlerësimin e fondeve të kërkuara buxhetore të aprovuara nga institucionet kompetente.

Këto programe formojnë bazën për bashkëpunimin rajonal dhe integrimin euroatlantik.

Faza e parë e reformës së sektorit të sigurisë ka qenë në kuadër të demokratizimit të vendit dhe bashkëpunimit me NATO-n dhe BE-në, rolin aktiv të OSBE-së dhe OKB-së, si dhe nismat rajonale në dhënien e ndihmës në mënyrë aktive për anëtarësimin të vendit në Nato dhe BE.

Në fazën e dytë që reformat që lëvizin drejt proceseve integruese duhet ndjekur hapat nga integrimi i vendeve më të zhvilluara në nivel kombëtar, dhe integrimin në nivel ndërkombëtar (euro-atlantik dhe rajonal).

Reformat duhet të përfshijnë të gjithë aktorët relevantë të shoqërisë me vendosmërinë për të mbështetur dhe zbatuar projektet (Parlamenti, Presidenti, Qeveria, Sektori akademik, OJQ-të, media, ekonomia dhe bashkësia ndërkombëtare).

Sa i përket rolit të Parlamentit, duhet të hartohen deklaratat e miratuara dhe ligjet e tjera të dokumenteve normative dhe politike për të fituar një vizion të qartë të sigurisë dhe mbrojtjes (mjedisi i sigurisë, sektori i sigurisë, menaxhimi dhe kontrolli).

Dokumentet e tilla duhet të jenë subjekt i diskutimeve publike dhe më gjerë dhe të kenë mbështetje publike.

Si një mënyrë të besueshme për të kapërcyer një parregullsi të caktuar në qeverisjen e sektorit të sigurisë, rolin e komisionit për mbrojtje dhe siguri në Parlament (me angazhim e këshilltarëve dhe ekspertëve) dhe rritja e bashkëpunimit me sektorin akademik dhe joqeveritar, si dhe sektori i biznesit bazuar në transparencë dhe llogaridhënie të qartë.³⁴

³⁴ http://www.eurm.edu.mk/publikacii/Zborik_Bezbednost_2012_1.pdf

Qeveria është një organ me përgjegjësi primare për sektorin e sigurisë kombëtare, dhe është me rëndësi të veçantë që ajo të përgatisë terrenin për zbatimin e vendimeve, si dhe të sigurojë bashkërendimin ndërmjet ministrive dhe agjencive shtetërore.

Siguria dhe stabiliteti i Republikës së Maqedonisë, janë të qartë dhe pa dyshim të shtrirë drejt NATO-s dhe BE.

Rajoni i Ballkanit Perëndimor doli nga një fazë pas konfliktit, të gjitha vendet e rajonit janë në një nivel tjetër në procesin e integritit euro-atlantik.

Vendet e rajonit dhe të Evropës janë objekt i krimit të organizuar dhe ky kërcënim për stabilitetin e vendit njihet përmes dimensioneve të jashtme të shprehura përmes trafikut kufitar të drogës, tregtia e prostitucionit, emigrantëve të paligjshëm, armëve dhe krimit të organizuar.

Në periudhën e ardhshme, prioritet duhet të jetë reduktimi i rreziqeve të tilla të sigurisë.

1.2. Sistemit i sigurisë në Maqedonin e Veriut

Ushtria është përgjegjëse për sigurinë e jashtme dhe i raporton Ministrisë së Mbrojtjes. Policia ruan sigurinë e brendshme, duke përfshirë edhe migracionin dhe mbrojtjen e kufijve, dhe përgjigjet para Ministrisë së Punëve të Brendshme. Autoritetet civile nuk i kanë tejkaluar mangësitë në mbikëqyrjen e efektivëve të policisë, në veçanti të njësisë për Kundërzbulim në Ministrinë e Brendshme, e cila, pa autorizim ligjorë ka përgjuar mbi 20.000 individ gjatë një periudhe disa vjeçare.

Në Ministrinë e Brendshme dhe në Zyrën e Avokatit të Popullit ka arritur një numër i madh i ankesave për përdorim të forcës gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare. Megjithatë, gjatë vitit ka pasur raporte për mosndëshkim që përfshijnë forcat e policisë.

Vëzhguesit ndërkombëtarë, ambasadat në vend dhe OJQ-të, në vend e kanë cekur korrupsionin, mungesën e transparencës dhe presionin politik në Ministrinë e Punëve të Brendshme si pengesë për luftimin e krimit, në veçanti krimit të organizuar. Përveç hetimit të pretendimeve për keqtrajtim policor, Sektori për Standarde Profesionale (SSP) i Ministrisë së Brendshme ka realizuar të gjitha hetimet e brendshme mbi pretendimet për forma tjera të sjelljes së keqe të policëve.³⁵

³⁵ Pendarovski Stevo, "Siguria ndërkombëtare", Shkup 2009

Sektori, gjatë hetimeve, ka të drejtën e shqiptimit të sanksioneve administrative, siç është suspendimi i përkohshëm nga puna, por nuk mund të ndërmer masa disiplinore që kërkojnë vendim nga komisioni disiplinor ose sanksione më serioze penale për të cilat nevojitet vendimi i gjyqit. Gjatë gjysmës së parë të vitit, sektori nisi masa disiplinore ndaj 110 efektivëve të policisë dhe ka ngritur 10 padi penale kundër punonjësve të Ministrisë së Brendshme për vepra penale, duke përfshirë edhe shpërdorim të pozitës zyrtare, mashtrim, dhe keqtrajtim në kryerjen e detyrës.

Plan 3-6-9 kahja e reformave të cilat Qeveria e Republikës së Maqedonisë i propozon dhe të cilat janë të vendosura në “Planin 3-6-9”, burojnë nga Programi për punë të Qeverisë 2017-2020, ndërsa merr gjithashtu parasysh edhe Marrëveshjen Politike të Përzahinos dhe ndjek rekomandimet që dalin nga takime të nivelit të lartë me përfaqësues të institucioneve të BE-së, udhëzimet e Komisionit Evropian rreth Reformave Urgjente Prioritare (2015), Rekomandimet e grupit të lartë të ekspertëve për çështje sistemore të sundimit të ligjit lidhur me ndjekjen e komunikimeve, si dhe një sërë rekomandimesh drejtuar Qeverisë gjatë viteve të fundit nga organet e Këshillit të Evropës (Komisioni i Venedikut, GREKO), rekomandimet e OSBE/ODIHR, gjetjet dhe rekomandimet nga Raportet vjetore të Komisionit Evropian, duke i përfshirë edhe ato nga dialogu me përfaqësues të lartë, konkluzionet e dialogut ministror për Programin për reforma ekonomike, konkluzionet nga mbledhjet e rregullta të organeve të Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocim, dokumenti i përgatitur nga një grup organizatash civile i titulluar si “Propozim për Reforma Urgjente Demokratike” (Blueprint) dhe rezultate nga konsultimet me shoqërinë civile.

Masat e propozuara nga grupi i parë, të përfshira në këtë plan, duhet të realizohen deri në mbajtjen e zgjedhjeve lokale. Masat tjera të cilat më detajisht do të përpunohen nga ana e institucioneve kompetente, do të hyjnë në grupin e dytë dhe të tretë të masave të cilat duhet të realizohen deri në nëntor/dhjetor, apo para mbajtjes së Këshillit të BE-së në dhjetor, si dhe ato që duhet të realizohen deri në mars të vitit të ardhshëm, apo deri në publikimin e radhës të Raportit të rregullt të Komisionit Evropian për Maqedoninë.

Qeveria vlerëson se reforma e shërbimeve të sigurisë dhe inteligjencës, është më se e nevojshme. Duke pas parasysh se bëhet fjalë për reformë gjithëpërfshirëse, Qeveria do të sigurojë debat transparent dhe gjithëpërfshirës, në të cilin procesi i konsultimeve do të zbatohet në mënyrë përkatëse. Reformat do të kryhen në mënyrë të veçantë dhe në terren, dhe pasi që të kemi

siguruar planin dhe dinamikën e qartë për ndryshimet e nevojshme, me çka do t'i mënjanojmë arsyet e shfaqjes së dobësive në mekanizmin e sigurisë dhe shërbimet e inteligjencës dhe do të rivendosim besimin në to.

Qeveria do të kujdeset që lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, nga letra të transferohet në praktikë, me lirim të mekanizmave nga ndikimi dhe presioni politik. Do të definojmë dhe implementojmë reforma që do të sigurojnë qëndrim të paanshëm dhe profesional ndaj çdo rasti të raportuar të korrupsionit, me qasje të barabartë dhe aplikim të ligjit për çdo qytetar të vendit. Këtë do ta bëjmë në mënyrë transparente dhe me respektim të plotë të të gjitha rekomandimeve që vijnë nga ekspert vendas dhe të huaj dhe nga shoqëria civile.

Në fushën e migracionit, Qeveria do të fillojë negociatat me Komisionin Evropian mbi Marrëveshjen statutare për (FRONTEX) Shërbimin Evropian për gardën kufitare dhe bregdetare, sepse konsideron se kjo është me interes të përbashkët për ne dhe për BE-në.

1.3. Përgjimi Ilegal

Në vitin 2015 me publikimin e regjistrimeve të pa ligjshme të komunikimeve u dëshmuar shkeljet në mes ministrave të qeverisë, zyrtarëve të lartë, anëtarëve të parlamentit, gjyqësorit, opozitës, shërbimit civil dhe medias. Këto incizime u bënë në mënyrë të paligjshme, jashtë gjykatës, nga ana e inteligjencës, Drejtoria për Siguri dhe Kundërzbulim.

Këto mangësi sistematike të cilat ata i ekspozuan apo konfirmuan, shkaktuan raportin e parë të Grupit të Ekspertëve në vitin 2015.

Ky gjest u vlerësua si dështim serioz i mekanizmit mbikëqyrës mbi Byronë e Kundërzbulimit dhe përqendrimi i pushtetit në këtë institucion.

Masat mbrojtëse të nevojshme, mekanizmat mbikëqyrës dhe masat e kontrollit të brendshëm nuk janë vënë në vend për të parandaluar çdo rrezik të përgjimit të paligjshëm.

Në raportin e vitit 2015, thuhet se skandali i përgjimeve tregoi një mosrespektim të etikës profesionale, parimet themelore të menaxhimit të punës dhe mungesën e njohurive për ndjeshmërinë e detyrës së inteligjencës.

Në vitin 2016, pas krizës dhe kritikave të forta autoritetet morën vendimin politik për të nisur të ashtuquajturin Projekti Inteligjent, për të cilin kanë marrë mbështetje organizative dhe metodologjike nga Gjeneva Qendra për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura

(DCAF), me qëllim të propozimit të një qasjeje gjithëpërfshirëse për reformimin e shërbimeve të inteligjencës në vend.

Kjo mbuloi modelet për përgjimin dhe qasjen në pajisjet e përgjimit, por edhe ripozicionimin e Byrosë për Siguri dhe Kundërzbulim. Ky projekt shikon aktorë të ndryshëm që kanë të bëjnë me sigurinë ose inteligjencën, përkatësisht Byronë për Siguri dhe Kundërzbulim, Agjencinë e Inteligjencës, Shërbimin e Sigurisë dhe Informacionit Ushtarak, Byroja e Sigurisë Publike (policinë), Zyra Doganore dhe Zyra e Policisë Financiare, si dhe disa organe mbikëqyrëse, përfshirë komisionet parlamentare dhe Drejtorinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Grupi i ekspertëve Evropian propozoi katër modele të ndryshme për menaxhimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e përgjimeve.

Në vitin 2015, për shkak të urgjencës, ekspertët e lartë rekomanduan që DSK-ja të mos ketë qasje të drejtpërdrejtë në pajisjet teknike që lejojnë pasqyrimin e komunikimit të sinjalit. Duke marrë parasysh kontekstin e ri në vitin 2017 dhe procesin e vazhdueshëm të reformimit të shërbimeve të inteligjencës, grupi i Ekspertëve Evropian përsërit rekomandimin e tij që qasja e drejtpërdrejtë e DSK-së në pajisjet teknike duhet të hiqet.

Korrupsioni është problemi më serioz me të cilin përballlet vendi pavarësisht nga çështjet specifike që rrjedhin nga kriza aktuale, e shkaktuar nga skandali i përgjimeve të komunikimit, i cili është fokusi kryesor i raporteve të Brukselit

Është thelbësore që këto veprime të ndiqen si çështje urgjente. Parandalimi dhe luftimi i korrupsionit në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fushat e veprimtarive publike duhet të bëhet prioritet parësor për Maqedoninë e Veriut.

Edhe ngjarjet e fundit vërtetuan se policia është totaleshit e partizuar. Duhet të bëhet departizim i plotë i policisë, të riorganizohet i tërë sistemi udhëheqës i Byrosë së Sigurimit Publik dhe mbi të gjitha ndryshimet dhe reformat në Drejtorinë e Sigurisë dhe Kundërzbulimit. Reformat janë shumë të nevojshme në MPB pasi që ky dikaster është i robëruar jo vetëm para 27 prillit por që kur ekziston shteti.³⁶

Reforma e sistemit të sigurisë, orientimet dhe vëllimi i ndryshimeve të parashikuara rezultojnë nga politika e sigurisë së vendit.

³⁶ <https://vlada.mk/plan-3-6-9>
https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2015/20151110_report_the_former_yugoslav_republic_of_macedonia.pdf
<https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-north-macedonia-report.pdf>

2. Përmirësimi i kushteve të Punës

Sot ne marrim një Marrëveshje kolektive moderne, të harmonizuar me standardet ndërkombëtare, ku në mënyrë të qartë përcakton procedurat që mundësojnë realizimin e të drejtave dhe detyrimeve të punonjësve në Ministrinë e Punëve të Brendshme që rrjedhin nga marrëdhënia e punës.

Përmirësimi i kushteve të punës dhe rritja e sigurisë, si dhe përgjegjësia e vendit të punës, është si parakusht për efikasitet më të madh në punë.

Në pajtim me Ligjin për punë të brendshme që rregullon vlerësimin efektiv mbi punonjësit e Ministrisë në marrëveshjen e re Kolektive është zhvilluar procedurë për zbatimin e masave të shkëlqyer në të cilin parashikohet vlerësimi i punëtorëve nga lista përfundimtare e notave për të gjithë punonjësit.

Përveç kësaj, procedimi disiplinor është thjeshtësuar dhe dispozitat e Marrëveshjes së re Kolektive janë të harmonizuara me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Punë të Brendshme, i cili parashikon rregullim të duhur, përkatësisht forcimin e sistemit të kontrollit dhe sekuestrimin e përkohshëm ose të përhershëm të armës zyrtare, në rastet kur ekziston një procedurë për çdo lloj dhune ndaj tyre, domethënë kur ka rrethana që personi zyrtar mund ta keqpërdorë armën zyrtare.

Në të njëjtën kohë, u harmonizuan me vendimet e Ligjit mbi Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, mënyra e përdorimit të pushimeve jashtë orarit, specifikat e së drejtës për leje prindërore, ngacmimi në punë dhe të ngjashme.³⁷

3. Korrupsioni dhe afëra e përgjimeve

Korrupsioni është njëra ndër format më të rënda si një paraqitje e përhapur në shoqëritë moderne, por fatkeqësisht, disa forma të korrupsionit janë bërë përditshmëri brengosëse për vendin tonë. Faktorët që e mundësojnë dhe ndikojnë në shfaqjen e korrupsionit më së shpeshti janë, mungesa e një baze të fortë ligjore, moszbatimi i ligjeve ekzistuese, mungesa e përvojës dhe aftësisë profesionale për ta luftuar korrupsionin, reformat në polici etj.

³⁷ <https://mvr.gov.mk/vest/88> 20 prill 2015
<https://mvr.gov.mk/vest/84> 30 prill 2015

Korrupsioni për nga natyra e punëve paraqitet dhe kryhet përmes pushtetit, pavarësisht nga cila anë fillon iniciativa, ndërsa lloji i lartë i korrupsionit sipas etiologjisë së saj dhe prirjes së saj ligjore merret si *eo ipso i ipso facto* (nga vetë fakti),

Edhe statistikat e ndryshme, si ato të brendshme, ashtu edhe ato ndërkombëtare tregojnë se viteve të fundit nuk ka ngelur pa u prekur asnjë shtet në tranzicion. Korrupsioni është një fenomen i njohur dhe i pranishëm edhe në vendin tonë, i cili shfaqet dhe shtrihet në forma të ndryshme.

Se Maqedonia është vend i përfshirë nga korrupsioni tregojnë edhe të dhënat e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Në gusht Qendra e Maqedonsë për Bashkëpunim Ndërkombëtar lëshoi raportin e tij dyvjeçar, i cili vuri në dukje se korrupsioni është rritur që nga viti 2014 dhe se prezenca e korrupsionit akoma mbetet e lartë.

Përgjimet e vitit 2015 kanë hedhur dritë edhe mbi disa raste ku zyrtarët qeveritarë kanë urdhëruar hakmarrje kundër bizneseve që besohet të jenë mbështetës të partive politike opozitare, duke përfshirë investitorët e huaj. Disa përfaqësues të bizneseve janë ankuar se inspektorët shpesh kanë vizituar zyrat me një "gjobë" të paracaktuar. Ka prova të tjera të besueshme se disa biznese janë të detyruar të paguajnë sponsorizim organizatave të ndryshme të kontrolluara nga Qeveria, ndërsa të tjerët të paguajnë "tarifa" të rregullta në mënyrë që të shmangin ngacmimin nga qeveria. Regjistrimet kanë treguar se qeveria, drejtpërdrejt dhe tërthorazi, ka kontrolluar një pjesë të konsiderueshme të kompanive të sektorit privat dhe ka thithur me forcë para prej tyre. Në kompensim, kompanitë që kanë bashkëpunuar me Qeverinë në mënyrë rutine kanë fituar tenderë shtetëror.³⁸

Të lehtësuar nga ligjet shpesh të paqarta dhe kontradiktore dhe me ndryshime të shpeshta, organet e inspektimit kanë vizituar kompanitë jo bashkëpunues dhe iu kanë shqiptuar dënime të rënda.

Krimet kanë përfshirë shpërdorim të pozitës dhe autoritetit zyrtar, pastrimin e parave ose pastrimin e të ardhurave të tjera kriminale, mitmarrje dhe pranimin e shpërblimit për ndikim të paligjshëm.

Që nga krijimi i Zyrës së Prokurorisë Speciale në shtator 2015, mediat pro-qeveritare kanë

³⁸ https://sq.wikipedia.org/wiki/Korrupsioni_n%C3%AB_Maqedoni
<https://telegrafi.com/tag/korrupsioni-ne-maqedoni/>

zhvilluar një fushatë të fuqishme dhe të koordinuar për të sulmuar besueshmërinë, integritetin dhe profesionalizmin e saj, dhe kanë favorizuar vendosjen e pengesave administrative në punën e saj, hetimet, dhe ndjekjet penale.

4. Transformimi i DSK-ës në Agjencinë për Siguri Kombëtare

Duke vepruar në bazë të neneve 175 dhe 176 të Ligjit për komunikim elektronik, secili prej tre ofruesve kombëtarë të telekomunikacioneve e pajis DSK-ën me aparate për përgjim, duke bërë të mundur që të pasqyrojë drejtpërdrejt të gjithë qendrat e tyre operationale.

Për pasojë , nga praktik, DSK mund të kapë komunikimet direkt, në mënyrë autonome, pavarësisht nëse është lëshuar një urdhër gjykate në pajtim me Ligjin për Ndalimin e Komunikimeve.

Skandali i vazhdueshëm tregon mungesë respekti për etikën profesionale, parimet themelore të menaxhimit dhe mungesës së njohurive për ndjeshmërinë e detyrës së inteligjencës pranë DSK-së. Mungesa e dukshme e stafit, njohuria dhe respekti për të drejtat themelore dhe rregullat e mbrojtjes së të dhënave është gjithashtu një pikë shqetësuese. Lidhjet familjare midis politikanëve të nivelit të lart dhe zyrtarëve të lartë në DSK, si dhe Prokurorisë Publike krijojnë një mjedis rreziku për konfliktet e interesit.

Sistemi i sigurisë shtetëror merret me mbrojtjen kundër spiunazhit, terrorizmit apo veprimtarive të tjera që synojnë të rrezikojnë ose shkatërrojnë institucionet demokratike të përcaktuara me Kushtetutën e Maqedonisë së Veriut, me mjete të dhunshme, si dhe mbrojtjen nga format më serioze të krimit të organizuar.

Zyra drejtohet nga një drejtor, i cili është i pavarur në kryerjen e punëve të Drejtorisë dhe është përgjegjës për punën e tij tek Ministri i Brendshëm dhe Qeveria, të cilët njëkohësisht e emërojnë atë për një periudhë katër vjeçare.

Me propozim të Drejtorit, Ministri miraton akte për organizimin, punën dhe sistematizimin e pozitave të Drejtorisë. Në kryerjen e veprimtarive brenda kompetencave të tij, punonjësit kanë të drejtë të mbledhin të dhëna, njoftime dhe informacione nga qytetarët, organet, ndërmarrjet dhe

³⁹ Др.М. Лабович,Македонска ревија за казнено право и криминологија,Скопје,стр.154
https://www.analyticamk.org/images/stories/files/report/r01_alb.pdf
<https://www.alsat-m.tv/reformat-ne-sherbimet-e-sigurise-ndarja-e-dsk-se-nga-mpb-ja/>

personat e tjerë juridikë të cilët janë të detyruar t'i mundësojnë kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë sa më profesionale.

Tani me ndryshimet e ligjit, DSK nuk ka të drejtë ligjore të dëgjojë përgjimin e regjistruar por vetëm do mbledh informacion, mund të regjistrojë vetëm me urdhër nga gjykata ku nuk ka të drejtë të dëgjoj. Pra, përveç të gjitha niveleve të kontrollit, DKS do ketë kontroll faktik real, të dyfishtë. Ky kontroll nënkupton që dikush do të përfshihet, nuk do të dëgjojë, ndërsa të tjerët do të dëgjojnë dhe nuk do të përfshihen.

Nga ndryshimet e ligjit, një nga opsionet është që DSK duhet të dalë nga Ministria e Brendshme. Këtu ka dy koncepte, koncepti i parë është decentralizimi i pushtetit, koncepti i dytë është centralizimi i pushtetit. Nëse duam të ngremë institucionet demokratike, të cilat do të shërbejnë për të mbrojtur shtetin dhe interesat e qytetarëve, zgjidhja më e drejtë është decentralizimi i pushtetit.

5. Formimi i ATO-së

Që nga afëra e përgjimeve, reformat në DSK ishin të patjetërsueshme për funksionim të shtetit ligjor të rregulluara në bazë të ligjit dhe kushtetutës së Shtetit.

ATO është themeluar si një organ i pavarur shtetëror që siguron një lidhje teknike midis operatorëve dhe autoriteteve. ATO do të veprojë si një autoritet ndërmjetës që krijon një transferim teknik midis operatorit dhe autoriteteve, pa mundësinë e aktivizimit ose lëshimit të regjistrimit të komunikimeve të marra. ATO nuk do të ketë mundësi teknike për të hyrë në përmbajtjen e komunikimit të ndjekur.

Lidhja teknike do të sigurohet vetëm në bazë të urdhrit të gjykatës për kryerjen e monitorimit të komunikimeve në pajtim me Ligjin për përgjimin e komunikimeve. Për të kryer kompetencat e përmendura agjencia do të pajiset me pajisje për ndërmjetësim për përgjimin e komunikimeve. Agjencia do të aktivizojë dhe krijojë kushte teknike për monitorimin e komunikimit të hetimeve penale dhe mbrojtjen e interesave të sigurisë dhe mbrojtjes së shtetit.

Do të sigurojë një lidhje teknike ndërmjet operatorëve dhe pajisjes për ndërmjetësim LEIMD të vendosur në ATO, sigurojë lidhje teknike midis pajisjeve teknike LEIMD dhe LEMF, nëpërmjet pajisjes LEMF që ndodhet në ATO do të sigurohet lidhje me stacionet tjera të cilat do e kenë këtë pajisje.

Hapësira ku do të ruhen pajisjet LEMF, deri atje do të arrihet vetëm nëpërmjet ndërmjetësimit të stacioneve të punës në organet e autorizuara, përmbajtjet e komunikimit të përgjuara automatikisht do të jenë të koduara.

Do të mundësohet mirëmbajtja e pajisjeve, gjithashtu edhe do të ketë dënime për keqpërdorim të pajisjeve nga punonjësit. Agjencia do të kryej mbikëqyrjen e ekspertëve mbi funksionimin e operatorëve.⁴⁰

Menaxhimi i kësaj agjencie bëhet nga një Drejtor, i cili zgjidhet dhe shkarkohet nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë me shumicë prej dy të tretave të votave të numrit të përgjithshëm të deputetëve dhe duhet të ketë shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të deputetëve që i përkasin komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë, me propozim të Komisionit për çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë. Mënyra e kryerjes së veprimtarive përcaktohet nga Drejtori i ATO.

Drejtori miraton aktet për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.

Neni 4, Paragrafi 3, thotë se për zgjedhjen e drejtorit, bëhet shpallja publike së paku në dy gazeta ditore të lëshuara në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë, njëra nga gazetatat është e lëshuar në gjuhë e folur nga së paku 20% e qytetarëve që flasin një gjuhë tjetër zyrtare nga Maqedonishtja, ku mandati i drejtorit është pesë (5) vite pa të drejtë rizgjedhje.

Drejtori duhet të jetë shtetas i RMV, të ketë së paku 240 kredi i arsimuar në fushën e informatikës, inxhinieri elektrike, teknologji kompjuterike dhe informatikë, inxhinieri telekomunikuese, siguri, shkencat juridike ose ekonomike, të kenë së paku dhjetë (10) vite përvojë pune pas përfundimit të arsimit në drejtimet e përfunduara.

Drejtori ka për detyrë ti paraqes Kuvendit të Republikës së Maqedonisë Veriut, raport vjetor mbi punën e agjencisë për një vit.

Nëse është e nevojshme dhe me kërkesë të Kuvendit drejtori dorëzon raporte shtesë.

Raporti duhet të publikohet në një vend të dukshëm, psh: në faqen e internetit të Kuvendit.

(1) Funkzioni i drejtorit kryhet profesionalisht dhe nuk është në përputhje me punën e një zyre tjetër publike, profesioni ose partie politike.

(2) Drejtori nuk merr pjesë në veprimtari politike dhe ngjarje që sipas llojit dhe karakterit, do të lejonin ekspozimin e tij politik (mbledhjet, tubimet, debatet publike). Neni 8

⁴⁰ <https://mvr.gov.mk/vest/5509>
<https://www.youtube.com/watch?v=kqO1cWbhfzQ>
<https://mvr.gov.mk/page/za-upravata>

Funksioni i Drejtorit para mbarimit të mandatit do të përfundojë në bazë të:

kërkesës së tij, nëse humbë aftësinë për të kryer funksionin, në qoftë se i plotëson kushtet për pension në përputhje me ligjin, nëse është dënuar me aktgjykim gjyqësor efektiv për një krim që e bën atë të padenjë për të kryer funksionin e tij.

(2) Arsyet për shkarkimin e drejtorit para skadimit të mandatit janë:

- nëse në raportet që organet mbikëqyrëse dhe kontrolluese, në pajtim me Ligjin për përgjimin e komunikimeve, dorëzojnë në Kuvend, kryerjen e paligjshme të punëve nën autoritetin e ATO,
- nëse pengon kontrollin dhe mbikëqyrjen e autoriteteve kompetente të përcaktuara në Ligjin për përgjimin e komunikimeve,
- nëse nuk respekton dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit, keqpërdorimin e pozitës zyrtare dhe autorizimin,
- bën shkeljen e sigurisë së informacionit të klasifikuar dhe keqpërdorimin e të dhënave personale. Thuhet në Nenin 9.

6. Byroja për siguri publike

Byroja e Sigurisë Publike është organ brenda Ministrisë që kryen punët e policisë në Ministri, organizimi dhe kompetencat rregullohet me Ligjin për Policinë.

Spektori për Kontroll të Brendshëm nuk është mjaft efektiv, sidomos kur bëhet fjalë për keqtrajtim, gjobat që vendosen ndaj punonjësve të policisë nuk duken mjaft bindëse.

Një mekanizëm mbikëqyrës i pavarur dhe efektiv për policinë duhet të krijohet dhe mekanizmi ekzistues duhet të zbatohet vazhdimisht.

Megjithëse ka kritere të qarta për rekrutimin dhe vlerësimin e punonjësve të policisë, ekzistojnë pohime të vazhdueshme të politizimit në polici.

Marrëdhëniet ndërmjet prokurorëve dhe policisë ende duhet të përmirësohen në mënyrë që shërbimi i prokurorisë të mund të luajë rol kryesor në hetimet.

Vetëm një nga qendrat e planifikuara multidisiplinore nën drejtimin e Prokurorit Publik është themeluar deri më tani dhe ende nuk ka staf të mjaftueshëm dhe të pajisur. Ende nuk ka ndërlydhje elektronike midis policisë dhe Prokurorisë Publike, e cila do të lejoë që informacioni

⁴¹ <https://mvr.gov.mk/Upload/Documents/Zakon%20za%20OTA.pdf>
Службен весник на РМ, бр. 71 од 19.4.2018 година ,20180711347

të ndahej në mënyrë efikase.

Qendra Kombëtare Koordinuese për Luftën Kundër Krimin të Organizuar është themeluar me ligj, por ende nuk është funksionale.

7. Kontrolli i brendshëm

Sipas Ligjit për Punë të Brendshme, Departamenti për Kontroll të Brendshëm është një njësi organizative e pavarur që ushtron kontroll të brendshëm për nevojat e Ministrisë dhe zhvillon procedurat për vlerësimin e ligjshmërisë së sjelljes së të punësuarve në Ministrinë e Brendshme. Në vitin 2015, Njësia për Kontrollin e Brendshëm, filloi procedurat disiplinore kundër 20 policëve të akuzuar për korrupsion në vitin 2014. Procedurat kanë rezultuar me gjopa kundër nëntë oficerëve dhe njëri u pushua nga puna.

Për të siguruar mbikëqyrjen e duhur të punës së policisë, pavarësia e njësisë duhet të forcohet dhe të krijohet një mekanizëm i jashtëm i mbikëqyrjes së Ministrisë së Brendshme.

Administrata doganore ka përmirësuar më tej procedurat për vlerësimin e rrezikut të korrupsionit.

Ai miratoi një kod të ri të sjelljes, zhvilloi hetime të brendshme dhe organizoi trajnime kundër korrupsionit.

Duke ndjekur 51 procedura disiplinore në vitin 2015, ishin 5 doganierë të dënuar për shkelje lidhur me korrupsionin (krahasuar me 4 në 2014). Administrata doganore ka nevojë për pajisje shtesë teknike në mënyrë që të mund të kryejë në mënyrë të pavarur masat speciale hetuese anti-korrupsion.⁴²

8. Mekanizmat për mbikëqyrjen e punës së MPB-ës

Me ligj janë krijuar një numër i organeve të pavarura mbikëqyrëse, si Zyra e Avokatit të Popullit, Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioni për Qasja në Informacion Publik dhe Këshilli i Agjencisë së Medias.

Megjithatë, disa prej përvojave të Ombudsmanit dhe Drejtorisë për Mbrojtjen e të Dhënave

⁴² <https://mvr.gov.mk/page/sektor-za-vnatreshna-kontrola>

Personale mund të ilustrojnë sfidat që ndikojnë në punën e këtyre organeve, në përgjithësi.

Organet e pavarura përballen me sfida të ndryshme që ndikojnë në funksionimin e tyre dhe në përmbushjen e roleve të tyre përkatëse.

a. Kontrolli i brendshëm, sipas Ligjit është njësi organizative e pavarur e Ministrisë që ushtron kontroll të brendshëm për nevojat e Ministrisë dhe i zhvillon procedurat për vlerësimin e ligjshmërisë së sjelljes së të punësuarve në Ministrinë e Brendshme.

b. Kontrolli i jashtëm, kryesisht bëhet nga organet më të larta të shtetit dhe jashtë aparatit të administratës që konsiston në zbatimin e plotë dhe të drejtë të akteve nënligjore dhe ligjeve gjatë kryerjes së funksioneve të tyre, pra organeve administrative. Me kontroll të jashtëm dëshirohet të arrihet pajtueshmëri e plotë e punëve dhe veprimeve të administratës me aktet ligjore dhe nënligjore.

c. Kuvendi, kryen kontroll që është mbikëqyrja e punës së Drejtorisë përmes një komisioni të përshtatshëm.

MPB i paraqet Komisionit të Kuvendit një program dhe një raport mbi punën për një vit.

Me kërkesë të Komisionit të Kuvendit, Ministria i jep pasqyrën e informacionin e nevojshëm, të dhënat dhe informatat relevante për punën e Komisionit të Kuvendit në lidhje me procedurën e punëve nën autoritetin e MPB.

Të gjitha të dhënat, njoftimet dhe informacionet e paraqitura në Komisionin e Kuvendit ose të paraqitura në një mbledhje të Komisionit do të jenë informacion me një shkallë të klasifikimit të përshtatshme. Anëtarët e Komisionit të Parlamentit janë të detyruar të mbrojnë informacionin e klasifikuar që ata e kanë mësuar apo pasur qasje gjatë ose në lidhje me punën e Komisionit të Kuvendit. Obligimi për të mbrojtur konfidencialitetin e informacionit të klasifikuar vazhdon edhe pas përfundimit të detyrës, anëtar i Komisionit të Parlamentit, ose ndërprerja e mandatit të Kuvendit, në përputhje me rregullat në lidhje me informacionin e klasifikuar.

d. Avokati i Popullit, është institucioni publik, i cili në mënyrë të vazhdueshme me mbrojtjen e interesave të qytetarëve nga keqpërdorimi i zyrtarëve shtetëror.

Avokati i Popullit zgjidhet nga parlamenti, që do të thotë se bazën ligjore e ka të rregulluar me Kushtetutë.

Ai ka të drejtë që në rast ankese nga qytetarët për abuzimin e të drejtës së tyre nga ana e administratës, të bëjë kontroll të drejtpërdrejtë ose tërthorazi të punës së tyre, ka të drejtë të kërkojë shpjegim nga organet, të kontrollojë procesverbalet e tyre dhe aktet e nxjerra nga ata, pra

vepron në kompetenca mjaft të gjëra.

Nëse vërteton se ndonjë procedurë nuk është udhëhequr në pajtim me ligjin, ai mund të propozojë që organi ta përsërisë atë, por nëse vërteton se e drejta e qytetarit është e cenuar nga nëpunësi, nga ai organ mund të propozojë ngritjen e procedurës disiplinore kundër tij.

Nëse është bërë cenim më serioz, mund të dërgoj kërkesë deri te prokurori publik për ngritjen e procedurës për konstatim të përgjegjesisë penale.

Nëse realizimi i ndonjë akti administrativ do të shkaktonte dëm të papërmisueshëm për palën, ai mund të çojë kërkesë për ndërprerje të përkohshme të zbatimit të aktit të tillë deri në sjelljen e vendimit nga organi i shkallës së dytë ose nga gjyqi kompetent.

e. Gjykata, si pushtet i tërësishëm i shtetit përveç punëve që kanë të bëjnë me çështje gjyqësore, kryen edhe atë të Kontrollit, respektivisht të kontrollit mbi administratën shtetërore.

Kontrolli gjyqësor konsiston në mbrojtjen kryesisht të ligjshmërisë dhe qytetarëve nga ana e administratës, me çka merret për bazë parimi i ligjshmërisë. Kontrolli gjyqësor i administratës nënkupton autorizimet të cilat i jepen një organi të pavarur nga pushteti politik dhe nga administrata që t'i zgjidhë konfliktet të cilat janë të shkaktuara në funksionimin e administratës. Kontrolli gjyqësor bëhet për disa arsye primare, verifikimi i ligjshmërisë me rastin e funksionimit të administratës, ndërhyrja në punët administrative me rastin e cenimit të të drejtave të qytetarëve, ndërhyrja në punët e administratës me rastin e verifikimit se me aktin e nxjerrë administrativ cenon të drejtën e dikujt, zgjidhja e kontesteve administrative, mbrojtja e interesave të nëpunësve shtetërorë dhe publik, personave zyrtar nga vet administrata.⁴³

⁴³ Fletushkë informimi mbi Avokatin e Popullit, Avokati i popullit i RM-së, OXO, Shkup Stavileci, po aty, fq. 129
Ibrahim Ceka, Qasje mbi parimet e administratës publike fq. 196, 199, 205, 209
<https://dspace.aab-edu.net/bitstream/handle/123456789/654/07c9d887-3b32-45d8-83bc-6df9f2359997.pptx?sequence=1&isAllowed=y>

9. Vettingu në Polici

Vettingu është procesi që shërben për përjashtimin e zyrtarëve publik, të cilët nuk kanë integritet në përmbushjen e detyrës dhe në këtë mënyrë, rikthehet besimi i publikut në punën e institucioneve shtetërore. Prosesi i vettingut, si rregull kryhet duke kontrolluar figurën e dikujt përpara se t'i ofrohet një vend pune. Në varësi të vendit të punës ose të projektit, procesi i vettingut mund të bazohet në kontrollin e aftësive, personalitetit, pasurisë ose të ndonjë faktori tjetër që lidhet me qëllimin e vettingut.

Vettingu është një proces serioz, i cili duhet të përfundojë pozitivisht për institucionin, por edhe proces i cili do të përballet me shumë pengesa edhe nga brenda por edhe nga jashtë. Nuk është i lehtë por duhet të jetë transparent.

Të gjithë jemi në dijeni për rastet dhe veprat e shumta në Republikën e Maqedonisë nga pjesëtarët e policisë, në disa raste edhe vetë jemi përballuar me këto skandale, si dhënia e ryshfetit, keqtrajtim, abuzim, etj.

Gjithashtu nga lansimi i Bombave dëgjuam shumë abuzime me pasuritë shtetërore, keqpërdorimin e detyrës zyrtare, kërcënime ndaj bizneseve të mëdha, mitmarje etj.

Thuaj se çdo segment i Ministrisë ishte i përfshirë në korrupsion, por edhe i kapur nga Politika dhe Pushteti.

Falsifikimi i diplomave Universitare dhe marrja e posteve kyçe në MPB, kontrolli dhe fitimi i pasurive të disa punonjësve, të gjitha statistikat dhe vlerësimet çuan deri tek Vettingu në Polici. Ministri aktual i Punëve të Brendshme theksoi se në policinë e vendit duhet të zbatohet vettingu. Ai njoftoi se për një gjë të tillë duhet të miratohet ligj i veçantë.

Ekzistojnë indikacione serioze se disa prej policëve, komandantëve dhe eprorëve që e kanë shumëfishuar pasurinë që nuk e kanë as biznesmenët që 20 vite kanë biznes në Maqedoni. Këtu e shoh interesin se pse është shumë atraktive të jeni pjesë e Policisë së Maqedonisë, kështu që në një shpallje për 30 të punësuar paraqiten 3.000 kandidatë. Sipas të gjitha gjasave motivim janë këta persona të cilët i shohin në përditshmëri.

Arsyet kryesore se pse duhet të zbatohet ky proces është zbulimi i më shumë se 50 rasteve që me diploma të falsifikuara janë bërë zyrtarë policor dhe kanë marrë poste udhëheqëse, por edhe për shkak të numrit të kryerësve të veprave penale nga ana e zyrtarëve policorë.

Në procesin e vettingut do të zbatohet në tri faza, dosjet personale, gjendje e patundshmërisë dhe

kriteret. Do të formohen komisione të cilat do të punojnë në veting, ndërsa do të ketë edhe komision të jashtëm me ekspert. Vettingut do t'i nënshtrohen të gjithë, nga pastruesit e deri tek ministri. Ky projekti i vettingut zbatohet nëpërmjet Këshillit Evropian.

Nga fillimi i këtij viti duhet të funksionojë edhe mekanizmi i jashtëm për kontroll të policisë.

Tani më është formuar repart i tillë në Prokurorinë për krim të organizuar.

Qëllimi është që punonjësit policor të jenë të vetëdijshëm se sjellja e tyre duhet të jetë në bazë të rregullave ligjore.⁴⁴

⁴⁴ <https://www.zaman.mk/al/macedoni/19041-se-shpejti-veting-ne-mpb-do-te-preke-te-gjithe-nga-pastruesit-e-deri-tek-ministri.html>
<https://www.botasot.info/macedonia/1022240/spasovski-na-duhet-veting-edhe-ne-policine-e-macedonise/>

SHTOJCA - MARRËDHËNIET NDËRMJET BE-së DHE ISH REPUBLIKËS JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë po merr pjesë në procesin e Stabilizim Asocimit.

Marrëveshja e Stabilizim Asocimit me BE është një kuadër për marrëdhëniet me BE-në, duke përfshirë dialogun politik dhe ekonomik.

Ekspertët u takuan në shtatë nën komitete, por grupi i posaçëm për reformën e administratës publike u anulua për shkak të mungesës së progresit në këtë fushë.

Debati në Komitetin e këtij viti u dominua përsëri nga kriza politike në vend, sundimi i ligjit dhe mungesa e përparimit dhe zhvillimeve negative lidhur me zbatimin e Prioriteteve Urgjente të Reformimit të miratuara në qershor 2015.

Takimi i Këshillit të Stabilizim-Asocimit nuk u zhvillua gjatë periudhës raportuese.

Vendi vazhdoi të zbatojë angazhimet nën MSA, duke përfshirë të gjitha ato që lidhen me fazën e parë të zbatimit të Titullit V (Lëvizja e punëtorëve, krijimi, ofrimi i shërbimeve, kapitali).

Këshilli ende nuk ka vendosur për propozimin e Komisionit për vitin 2009 për kalimin në fazën e dytë të Shoqatës, sipas nenit 5 të MSA-së.

Protokolli i Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit për të marr parasysh pranimin e Kroacisë në BE është ratifikuar nga Parlamenti.

Protokolli 4 i ndryshuar i Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit u ratifikua për të përfshirë dispozitat për zbatimin e Konventës Pan-Euro-Med mbi rregullat preferenciale të origjinës.

Vendi është gjithashtu i angazhuar në një dialog të zgjeruar ekonomik shumëpalësh me Komisionin dhe me Shtetet Anëtare të BE-së për tu përgatitur për pjesëmarrje në mbikëqyrjen multilaterale dhe koordinimin e koordinimit ekonomik nën Bashkimin Ekonomik dhe Monetar të BE-së.

Liberalizimi i vizave për qytetarët e vendit që udhëtojnë në zonën Shengen ka qenë në fuqi që nga dhjetori 2009.

Si pjesë e mekanizmit të monitorimit, Komisioni ka qenë duke vlerësuar rregullisht progresin e bërë nga vendi në zbatimin e reformave të paraqitura në udhërrëfyesin e vizave.

Marrëveshja e ripranimit midis BE dhe vendit ka qenë në fuqi që nga viti 2008.

Komiteti i Përbashkët i Ripranimit u mbajt në Shkup më 21 qershor.

Gjatë periudhës 2007-2013, BE ofroi ndihmë financiare për vendin sipas instrumentit të ndihmës

së para-anëtarësimit (IPA).

Ajo ka ndarë gjithsej 610 milionë euro në vend, të plotësuar me programe multi-përfituese IPA. Nga kjo shumë e përgjithshme, autoritetet kombëtare janë drejtpërdrejtë përgjegjëse për menaxhimin e rreth 470 milion euro sipas sistemit të decentralizuar të zbatimit (DIS).

Vonesat në prokurimin nën DIS i çuan në një situatë në të cilën vendi nuk ishte në gjendje të absorbojë 117 milionë euro nga fondet IPA.

Shifrat e përgjithshme të de-angazhimit pritet të rriten, pasi masat e marra nga autoritetet kombëtare për të përmirësuar menaxhimin e ndihmës IPA nuk kanë treguar ende rezultate reale. Kapaciteti administrativ për të planifikuar, dizajnuar dhe zbatuar projekte mbetet çështje shqetësuese, së bashku me rregullat për financat e shëndosha të menaxhimit.

Prandaj, vendi është në rrezik për të vazhduar të përdorë fonde IPA të konsiderueshme.

Sipas IPA II, BE i akordoi vendit 664 milionë euro për zbatimin e reformave.

Në nëntor të vitit 2015, Komisioni miratoi programin e dytë vjetor IPA II, i cili u zvogëluua ndjeshëm për rreth 22 milionë euro për shkak të mungesës së gatishmërisë dhe mungesës së vullnetit politik për të hartuar një program të besueshëm dhe të rëndësishëm programesh për mbështetjen e buxhetit në publik, menaxhim financiar.

Marrëveshja e financimit për programet shumëvjeçare për transport dhe mjedis, e menaxhuar në mënyrë indirekte, pritet të nënshkruhet në shtator 2016.

Zbatimi në kuadrin e IPA II është në fazat e tij të hershme, me disa kontrata të nënshkruara vetëm nga EUD.

Sfidat kryesore mbeten paaftësia ose mungesa e gatishmërisë së qeverisë për të përgatitur reforma thelbësore në fushat kyçe.

Si përgjigje, komisioni Evropian ka ndarë ndihmën financiare 15.5 milion euro për ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, si dhe 4.4 milionë euro ndihma humanitare.⁴⁵

⁴⁵ <https://mvr.gov.mk>
https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_the_former_yugoslav_republic_of_macedonia.pdf

Këto shtojca janë marr nga faqet e internetit dhe janë kopje të pa përpunuara.

Përfundim

Reforma në sistemin e sigurisë, konkretisht në Ministrinë e Brendshme ka patur që nga formimi i Maqedonisë Veriut si shtet, ku akoma vazhdojmë të kemi reforma në fusha të ndryshme.

Me reforma synohet përmisimi i sigurisë së shtetit dhe qytetarëve, mbrojtja e demokracisë dhe promovimi i vlerave Evropiane, si dhe synimet strategjike të vendit drejt Nato-s dhe BE-së.

Duke ditur që Ministria e Brendshme dhe policia, është organ delikat dhe një nga resoret më të rëndësishëm në shtet, nevoja për reforma dhe kontroll më të shpeshtë dhe gjithëpërfshirës si nga vetë organet e brendshme të ministrisë por edhe nga jashtë me qëllimin e vetëm të respektimit të pozitës së punës dhe funksionimit në përputhje me ligjet në fuqi.

Kontrolli i regullt nga vetë ministria dhe eprorët policorë nuk do të lejonin që korrupsioni të depërtonte në cdo organ të ministrisë.

Ministria e Brendshme si resorë i kapur kryekput nga ish pushteti qeveritarë, solli deri atë pikë që ti zbulonin krimet në mes veti, ku nga drejtoria e intelgjencës në mënyr ilegale ishin përgjuar më shumë se 20,000, qytetarë dhe njerëz nga të gjithë shtresat, të gjithë funksionet kryesore dhe funksionarët shtetëror, biznesmen, etj.

Me lansimin e këtyre përgjimeve u zbuluan skandalet e ndryshme, si korrupsioni, ndikimi politik në ushtrimin e detyrave shtetërore, fitimi i tenderëve shtetëror, kërcënime, raste të montuara etj.

Me ndihmën e Bashkimit Evropian filluan reformat urgjente që tejkaluan krizën e thellë në shtet.

Ministria e brendshme me zgjedhjen e një nga katër modelet e propozuara nga BE-ja, filloj reformat rënjësore në cdo segment dhe drejtori të veten, me të vetmin qëllim të pastrimit të ministrisë nga ndikimi politik dhe korrupsioni që institucioni të jetë në shërbim të qytetarëve.

Ndryshimi i punës së policisë përfshin ndryshimin e të kuptuarit të punës së policisë jo vetëm si një e drejtë ekskluzive, por edhe subjekteve jo politike, sepse nuk është vetëm ajo që policia profesionale bën brenda modelit tradicional të policisë.

Reformat paraqesin një trend të harmonizimit të legjislacioneve pozitive me konventat ndërkombëtare, përkatësisht me ato Evropiane, të cilat duhet të orientohen drejt aftësimin të sistemit administrativ në procedurat e realizimit të kërkesave të qytetarëve dhe të nevojave të shoqërisë.

Meqenëse deri tani janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm në miratimin e ligjeve përkatëse, ato mund të llogariten vetëm si hapa reformues normativ.

Duke pasur parasysh se ndryshimi në punën e policisë nuk është aspak i lehtë dhe operacion i thjeshtë, sepse ndikohet nga një sërë faktorësh, ky ndryshim duhet të shihet si një proces i gjatë dhe i qëndrueshme që i paraprin përmbushjes së disa parakushteve.

Një qëndrim i rezervuar për efektivitetin e çështjeve të caktuara të policisë ekziston për të zbuluar dhe kapur kryesit, për mbikëqyrjen e shtuar të policisë dhe për kontrollin e autorëve të regjistruar të veprave penale.

Shteti jonë me një qëllim afatgjatë është duke luftuar për të mbrojtur integritetin dhe pavarësinë e vet, është fuqimisht i përkushtuar në luftimin e të gjitha llojeve të krimit të organizuar në të gjitha format, për të parandaluar migrimin ilegal dhe trafikimin me qenie njerëzore, luftën kundër trafikimit të drogës dhe transaksioneve të paligjshme të armëve dhe pajisjeve ushtarake. Sistemi i sigurisë kombëtare përcakton qartë strukturën dhe entet kompetente që ndërmarrin masa dhe aktivitete brenda kuadrit të kompetencave të përcaktuara me ligj dhe krijojnë mekanizma për bashkëpunim dhe koordinim të të gjitha njësive për funksionimin efikas të sistemit.

Me ndihmën e faktorit ndërkombëtar, u ndryshuan disa ligje ku shihej nevoja më e madhe, dhe shumë ligje tjera janë propozuar dhe janë në proces të ndryshimeve.

Nga ligjet e reformuara sistemi i MPB-ës, filloi të funksionojë më lirshëm, dhe pati ndryshime në përmirësimi i kushteve të punës policore, pastrimi i policisë nga politika, marrja e kompetencave të Byrosë Publike të Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim, formimi i Agjencisë për Siguri Kombëtarë, dhe fillimi i Vettingu në Polici.

Nëse duam një polici Evropiane dhe që shteti jonë t'i bashkëngjitet familjes së madhe Evropiane, shpresojmë që reformat e filluara sidomos ato në sistemin e sigurisë t'i ndjekin instruksionet nga Bashkimi Evropian dhe grupi i Ekspertëve, që ligjet e reformuara dhe proceset reformuese të përfundojnë me pozitivitet për vendin, institucionet e vendin tonë, politikanët dhe policia të ndjekin hapat dhe rrugën drejt BE-së dhe NATO-s.

Bibliografia

1. E. Aziri, N. Maliqi, A. Pajaziti, *Proceset e Integrimit Euroatlantik dhe Republika e Maqedonisë*, Tetovë, 2008
2. I. Zendeli, V. Kambovski, N. Janiçeviç, V. Latif, Z. Sulejmanov, B. Netkova, J. Ilievski, Z. Milovanoviç, T. Kikerekova *Kriminaliteti i Organizuar Aspekte Juridike*, Tetovë, 2009
3. Ibrahim Ceka, *Qasje mbi parimet e administratës publike*, Shkup
4. Esat Stavileci, *Hyrje në shkencat administrative, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Kosovës*, Prishtinë, 1997
5. Rade Rajkovçevski, *Ndërtimi i politikës së sigurisë: Rasti i Republikës së Maqedonisë*, Shkup
6. *Revistë Vizione*, për shkencat shoqërore Nr. 2/3, shoqata e intelektualëve Klubi Demokratik, Shkup dhe Unioni i inteligjencës Shqiptare në Maqedoni
7. Abdulla Aziz, *Reformat në Administratën Publike në RM, drejt integritimeve Evropiane*, ligjërata të zgjedhura, 2006
8. Mr.sc. Sadik Zenku, *Institucionet e Bashkimit Evropian dhe procesi i integrimit të Maqedonisë në Bashkimin Evropian*, Kërçovë, 2013
9. *Revistë Vizione*, për shkencat shoqërore Nr. 4, shoqata e intelektualëve Klubi Demokratik, Shkup dhe Unioni i inteligjencës Shqiptare në Maqedoni.
10. Al-Rodhan, N 2008, *The three pillars of sustainable national security in a transnational world*, lit verlage, Berlin, Germany.
11. Batkovski, T 2012: *Security of the Republic of Macedonia through the prism of modern greater Albania aspirations*, in C Mojanoskis, *security and euro-atlantic prespectives of the balkans & police science and police profession (states and prespectives)*, International scientific conference proceedings, volum II, University "St.Kliment Ohridski"- Bitola & Faculty of Security-Skopje, pp 1-8.
12. Pendarovski Stevo, "Siguria ndërkombëtare", Shkup 2009
13. *Perspektiva Euro-atlantike të R. Maqedonisë*, Botues UEJL, Tetovë, qershor 2009
14. Mr.sc. Sadik Zenku, *Bashkimi Evropian, kronologjia e zhvillimit dhe sfidat e zgjerimit*, Kërçovë, 2014
15. Aziz.A, *Bashkimi Evropian*", e drejta institucionale dhe politikat, Tetovë 2010
16. *Dispensë, E Drejta Policore*, Jeton Shasivari, Tetovë, shkurt 2016
17. Avziu.Q. *Hyrje në Kriminalistik*, 2015 Tetovë
18. Artan Ibrahim, *Integrimi i Ballkanit Perëndimor në UE*, Shkup 2009

19. Institucionet e Bashkimit Evropian, Botimi 5, përkthim shqip, 2007
20. Blerim Reka, Studime Evropiane, UEJL, Tetovë, 2004
21. The Security Service (MI5), © Crown Copyright 2012
22. Douglas T. Stuart: Creating the National Security State: A History of the Law That Transformed America, 2012
23. МО на РМ, Бела книга на одбраната –нацрт верзија, Скопје, 2012.
24. Закон за внатрешни работи СВ на РМ бр. 92/09.
25. Закон за изменување и дополнување на Законот за внатрешни работи СВРМ бр.35/10; Исправка на Законот за внатрешни работи СВРМ бр.118/ 09.
26. CARPO Regional Project, 2007. "Update of the 2006 Situation Report on Organized and Economic Crime in South-eastern Europe", European Commission, Council of Europe, Strasbourg.
27. Митко Котовчевски, Тајните служби на Балканот, Бомат графикс, Скопје, 2007.
<http://www.europarl.eu.int/enlargement/briefings/>
28. Азески, Д. Миграцијата кон Скопје го уништува животот во главниот град, 22 јуни 2012, достапно на
www.kapital.mk/mk/makedonija/85581/migracijata_kon_skopje_go_unishtuva_zhivotot_vo_glavniot_grad.aspx
29. Дојчиновска, Р. (2013). Основи на превентивно полициско работење, Отсек за превенција и ПСОИ-СВР Скопје.
30. Стефановска, В. (2010). Реасемблинг (миротворна) криминологија: реалност или заблуда”, Годишник на факултетот за безбедност, Скопје, стр.273-281.
31. Esat Stavileci –Nocione dhe Parime të Administratës Publike, Prishtinë 2005
32. E.Aziri, J.Abdullai, A.Pajaziti, M.Memeti-Shteti i së Drejtës dhe Reformat në Administratën Publike: Rasti Maqedonia, Tetovë 2008

Dokumente burimore

1. Kushtetuta e RM-së, Studentski zbor, Shkup, 2002
2. Dokumentet themelore të OKB-së
3. Dokumentet themelore të OSBE-së
4. Deklaratat e Brukselit 2015, 2017
5. Ligji për Mbrojtjen Sociale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 148/2013
6. Ligji për Policinë, Gazeta Zyrtare e RM nr. 145/2012
7. Kodi i Etikës Policore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë 114/2006
8. Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 19/2014
9. Rregullore për kryerjen e punëve policore, Gazeta Zyrtare e RM nr. 117/2014
10. Strategjia për trajnimin e të punësuarve në Ministrinë e Brendshme 2012-2014
11. Plani Strategjik i Ministrisë së Brendshme 2014 -2016

Burime Iterneti

https://mk.usembassy.gov/wp-content/uploads/sites/249/2017/04/hrr2016_macedonia_alb.pdf

https://mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/Strategija%20za%20razvoj%20na%20CO%20final%20CS.pdf

https://www.youtube.com/watch?v=Q1nL62_wiFI

<https://www.alsat-m.tv/ekspertet-reformat-ne-mpb-urgjente-dhe-te-pashmangshme/>

https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news_corner/news-news-files/20150619_recommendations_of_the_senior_experts_group.pdf

https://ec.europa.eu/neighbourhoodenlargement/sites/near/files/2017.09.14_seg_report_on_systemic_rol_issues_for_publication.pdf

http://www.eurm.edu.mk/publikacii/Zborik_Bezbednost_2012_1.pdf

<https://mvr.gov.mk/page/strategii>

<http://nacionalnakomisija.gov.mk/wp-content/uploads/2016/12/Nacionalna-strategija-i-akciski-plan-za-borba-protiv-trgovija-so-lugje.pdf>

https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/bpt_nacionalna_strategija_2018.pdf

https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/sne_nacionalna_strategija_2018.pdf

<http://zdravstvo.gov.mk/wp-content/uploads/2018/03/mkd-strategija-za-opojni-drogi-2014-2020.pdf>

<http://www.ufr.gov.mk/files/docs/NS.pdf>

<http://igu.gov.mk/?q=node/9%C2%A0%20%C2%A0>

https://www.analyticamk.org/images/stories/files/report/r01_alb.pdf